

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit...
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Zhvillim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	• Direktiva (BE) 2017/1132 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 14 qershorit 2017 lidhur me disa aspekte të së drejtës së shoqërive tregtare (kodifikim), FZ L 169, 30.6.2017, f. 46–127, ndryshuar kryesisht nga (i) Direktiva (BE) 2019/1151 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 qershorit 2019, që ndryshon Direktivën (BE) 2017/1132 sa i përket përdorimit të mjeteve dhe proceseve digjitale në të drejtën e shoqërive tregtare, PE/25/2019/REV/1, FZ L 186, 11.7.2019, f. 80–104 (ii) Direktiva (BE) 2019/2121 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 27 nëntorit 2019, që ndryshon Direktivën (BE) 2017/1132 sa i përket shndërrimeve, bashkimeve dhe ndarjeve ndërkufitare, PE/84/2019/REV/1, OJ L 321, 12.12.2019, f. 1–44
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2025-2027 Dokumenti i Vlerësimit të Ndikimit të Politikave
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	Data/Asnjë konsultim publik.
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Data e vlerësimit të ndikimit

A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po/Jo Data e shqyrtimit
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)</i> Procesi i harmonizimit të ligjit 9901/2208 për tregtarët dhe shoqëritë tregtare në Shqipëri me acquis-in e Bashkimit Evropian, nën Kapitullin 6, është një aspekt kyç i integritetit të Shqipërisë në BE. Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me rregulloret e BE-së është thelbësor për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, duke krijuar një mjedis të transparencës, konkurrencës dhe rritjes. Sipas raportit të fundit të Komisionit Evropian për vitin 2024, Shqipëria është përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e ligjit 9901/2008 tregtare. Edhe pse janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të përmbushur kërkesat e BE-së, Shqipëria ligjit 9901/2008 duhet ende të përafrojë disa aspekte të cilat ligji nr. 9901/2008 për tregtarët dhe shoqëritë tregtare (“ligji për shoqëritë tregtare” ose “ligji 9901/2208”) aktualisht nuk e rregullon. Këto dispozita që duhen përafuar synojnë forcojnë kontrollin dhe transparencën në funksionimin e shoqërive tregtare, duke përfshirë regjistrimin elektronik të degëve, ndalime për administratorët me precedentë penalë dhe rregulla për shpërndarjen e fitimit dhe zotërimin e aksioneve të veta. Për herë të parë rregullohet pavlefshmëria e bashkimeve dhe pranimit të aksioneve si garanci, në përputhje me standardet e BE-së. Këto ndërhyrje synojnë të përmirësojnë qeverisjen korporative dhe të rrisin sigurinë juridike në treg.. Mungesa e përafrimit mund të sjellë disa probleme, duke përfshirë vonesa në adaptimin e rregulloreve përkatëse, mungesën e një infrastrukture të digjitalizuar të plotë dhe shpërndarjen e informacionit.. Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme për të adresuar këto boshllëqe, për të krijuar një kuadër ligjor të qartë dhe të qëndrueshëm që do të sigurojë transparencë dhe siguri ligjore për bizneset, si dhe do të përmirësojë mjedisin e investimeve dhe integritetin në tregun e BE-së. Pasoja e këtij procesi është përmirësimi i konkurrencës së Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare dhe përmbushja e kërkesave për anëtarësim të plotë në BE.	
OBJEKTIVAT <i>Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)</i> Ky vlerësim i ndikimit rregullator (RIA) për harmonizimin e ligjit shqiptar të shoqërive tregtare me Direktivën 2017/1132 ka si objektiv sigurimin e përputhshmërisë të ligjit shqiptar me standardet e Bashkimit Evropian. Ky proces ka si qëllim krijimin e një mjedisi ligjor të qëndrueshëm, të parashikueshëm dhe transparent për bizneset dhe investitorët, duke siguruar të drejtat e aksionarëve dhe trajtimin e çdo çështjeje ligjore sipas direktivës që nga themelimi i shoqërive deri tek publikimet e nevojshme. Ligji shqiptar duhet të harmonizohet me kërkesat e Direktivës 2017/1132, duke siguruar mbrojtjen e aksionarëve, promovimin e angazhimit afatgjatë të aksionarëve, përjashtimin	

e administratorëve dhe lehtësimin e procedurave për shoqëritë që operojnë në tregjet e BE-së, përditësimin dhe pavarshmërinë e procedurave të bashkimit etj. Objektivi është gjithashtu përmirësimi i transparencës dhe sigurimi i një kuadri ligjor që do të kontribuojë në rritjen e konkurrencës dhe zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm për bizneset dhe investitorët, duke nënkuptuar një rregullim të plotë të legjislacionit shqiptar për të përmbushur kërkesat e rregullave të Bashkimit Evropian.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0 (status quo)- nënkupton vijimin me kuadrin ligjor aktual. Ky nuk është një opsion i përshtatshëm për t'u zbatuar sepse mbajtja e kuadrit ligjor aktual pa reforma të rëndësishme do të çonte në mos përputhshmëri të vazhdueshme me direktivat kyçe të BE-së.

Opsioni 1 (Ndryshime në ligjin ekzistues) i preferuar -nënkupton ndryshime në ligjin ekzistues për shoqëritë tregtare. Ky opsion fokusohet në një qasje konservatore për harmonizimin e ligjit 9901/2008 tregtare në Shqipëri me direktivat e BE-së. Ai përfshin adresimin e boshllëqeve të identifikuar në Përkufizimin e Problemit, duke u bazuar mbi skeletin ekzistues ligjor, ndërtuar njëkohësisht kapacitetin institucional të nevojshëm për të zbatuar këto reforma. Veprimet kyçe përfshijnë ndryshime të ligjit në mënyrë graduale, në kuptimin që të identifikohen vetëm ato nene të ligjit që nuk janë të përafëruara në mënyrë që të garantohet përputhshmëria ligjore me Direktivat e zbatueshme.

Opsioni 2 (Miratimi i një ligji të ri): Miratimi i një ligji të ri të shoqërive tregtare ose Kodifikimi i tij si në nivel BE-je në Republikën e Shqipërisë është gjithashtu një opsion për t'u zbatuar, por kërkon përpjekje masive në një mjedis ende shumë dinamik për të pasur një legjislacion tregtar të kodifikuar. Ky opsion mbështet një qasje më agresive, duke synuar transpozimin e shpejtë të plotë të të gjithë ligjeve tregtare (ligjit për shoqëritë tregtare, bashkimet, ndarjet shndërrimet ndërkufitare, regjistrimi i biznesit, ligji për QKB-në) në një ligj unik dhe masiv shoqërive tregtare. Kjo qasje formalisht mund të imitojë direktivën e BE-së 2017/1132 por produkti do jetë një ligj që për nga natyrë nuk do të ngjajë asnjë ligji tjetër shqiptar për nga madhësia dhe do të bëjë që përdoruesit ta kenë shumë të vështirë ta shqyrtojnë. Ky ligj i kodifikuar mund të ngarkojë shumë institucionet shqiptare, duke kërkuar mbështetje serioze financiare dhe njerëzore.

Opsioni 3 (Jo rregullator): Një opsion jo rregullator do të nënkuptonte lejimin e bizneseve dhe aktorëve të tjerë të funksiononin pa një kuadër të detajuar rregullator ose me ndërhyrje minimale nga shteti, duke lejuar vetë-rregullimin dhe pajtimin vullnetar me standardet e BE-së. Ky opsion do të bënte që shoqëritë mund të operonin pa detyrime ligjore të plota për transparencë, mbrojtjen e të drejtave të aksionarëve, ndërlidhje, norma të zbatueshme për administratorët etj., duke krijuar një mjedis më të lirë për bizneset.

Megjithatë, ky opsion nuk është i papranueshëm për Shqipërinë, pasi vendi është i detyruar të harmonizojë legjislacionin e tij me kërkesat e BE-së për integrimin në tregun e brendshëm të BE-së. Mungesa e një kuadri të detajuar rregullator do të shkaktoje pasiguri ligjore, do të dëmtonte besimin e investitorëve dhe do të dëmtonte përpjekjet për të siguruar një mjedis të drejtë dhe transparent biznesi. Po ashtu, nuk do të ishte në përputhje me angazhimet e Shqipërisë për t'u anëtarësuar në BE dhe do të krijonte një ambient të pasigurt për zhvillimin e biznesit, duke penguar mundësitë për rritjen e investimeve të huaja dhe përmirësimin e konkurrencës.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)

Zbatimi i opsioneve të politikës që synojnë harmonizimin e ligjit 9901/2008 në Shqipëri me acquis-in e BE-së nën Kapitullin 6 do të ketë ndikime të gjera ekonomike, sociale dhe institucionale. Këto ndryshime nuk do të prekin vetëm kuadrin ligjor dhe rregullator, por do të luajnë gjithashtu një rol kyç në përmirësimin e mjedisit të biznesit në Shqipëri, rritjen e tërheqjes për investimet e huaja (FDI) dhe përsheptimin e integritetit të Shqipërisë në BE. Kjo pjesë do të vlerësojë ndikimet ekonomike, sociale dhe institucionale të pritura, duke marrë parasysh si efektet afatshkurtra ashtu edhe ato afatgjata, si dhe kostot dhe përfitimet e mundshme që lidhen me secilin opsion të politikës.

Nga ana ekonomike, do të përmirësohet besimi i investitorëve dhe do të rritet tërheqja e investimeve të huaja të drejtpërdrejta (FDI), duke krijuar një mjedis biznesi më të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm. Harmonizimi me rregullat e BE-së do të lehtësojë qasjen në tregjet e brendshme të BE-së dhe do të nxisë konkurrencën. Sidoqoftë, kostot e menjëhershme të rishikimit të ligjit dhe përditësimit të sistemeve mund të ndikojnë, por përfitimet afatgjata do t'i tejkalojnë këto kosto.

Ndikimi institucional do të përfshijë forcimin e kapaciteteve të institucioneve. Amendimet do të sjellin nevojën për përshtatje nga Qendra Kombëtare e Biznesit, e cila duhet të krijojë dhe administrojë regjistrin e ndalimeve për administratorët dhe të zbatojë standarde të reja për regjistrimet dhe transparencën. Gjithashtu, kërkohet përfshirja e Ministrisë së Ekonomisë, gjykatave dhe autoriteteve të tjera për zbatimin dhe mbikëqyrjen e rregullave të reja, duke imponuar trajnime, zhvillim IT dhe rregullore zbatuese të posaçme.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta).

Opsioni i preferuar është Opsioni 1- Ndryshime në ligjin ekzistues.

Ky opsion është i përshtatshëm për t'u zbatuar për arsye se:

Përfitimi kryesor i këtij opsioni është harmonizimi i shpejtë i ligjit me acquis-in e BE-së, i cili do të përmirësojë mjedisin e biznesit të vendit, do të nxjerrë përparësi për rritjen ekonomike dhe do të mundësojë një integritet më të thellë në tregun e BE-së. Përputhshmëria e plotë duke ndryshuar ligjet përkatëse, do të krijojë një mjedis ligjor më të parashikueshëm dhe transparent, sepse do të ndërtohet mbi bazën e një ligji që tashmë është i zbatueshëm prej vitesh. Institucionet dhe profesionistët do ta kenë më të thjeshtë punën me këto ligje sepse do ti referohen vetëm ndryshimeve të nevojshme për efekt përafrimi dhe zbatimi.

Kostot buxhetore të implementimit të Opsionit 1 janë disa, por të menaxhueshme në kuadrin e strategjisë më të gjerë të integritetit të Shqipërisë në BE. Investimet e nevojshme do të drejtohen kryesisht në ndërtimin e kapaciteteve institucionale, duke përfshirë programe trajnime për profesionistët, krijimin e infrastrukturës digjitale për operacionet ndërkufitare etj..

Nga analiza e kryer, bazuar në kriteret përkatëse, si dhe duke vlerësuar secilin opsion, rezulton se opsioni 1 ka prioritet krahasuar me opsionet e tjera.

Si rezultat, vlerësojmë se opsioni më i përshtatshëm do të jetë opsioni 1, i hartimit të ndryshimeve dhe/ose përshtatjeve ligjore të ligjeve ekzistuese.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë) është e vështirë të llogaritet me besueshmëri. Do të jetë e nevojshme të ndryshohet ligji gjë që përkthehet në kosto për ekspertët, kosto për trajnime si dhe kosto për ndërgjegjësimin e grupeve të prekura siç janë bizneset. Në fazën fillestare është e vështirë të maten kostot me besueshmëri por mund të vlerësohet se ato nuk arrijnë më shumë se 20 milionë lekë në tre vitet e para, vlerë që nuk është e rëndësishme krahasimisht me përfitimet e pritshme:

Viti 1	Viti 2	Viti 3
20,000,000	20,000,000	20,000,000

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

Projektligji është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, në datën _____ me afat publikimi datën _____, me nr. shikimesh _____,

Sqarojmë se publikimi i projektligjit është bërë me titullin “ _____”, por bazuar në komentet e ardhura gjatë procesit të konsultimit me ministrinë e linjës, projektligji është ripunuar në terësi.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Bazuar në projektligj, organet që parashikohen për zbatimin e nismës së propozuar janë:

- Ministria përgjegjëse për ekonominë;
- Qendra Kombëtare e Biznesit;
- Ministria përgjegjëse për financat;
- Administrata tatimore
- Ministria përgjegjëse për mbrojtjen e sipërmarrjes
- Autoriteti i Konkurrencës

Çdo institucion do të marrë përgjegjësi për implementimin e komponentëve të caktuar të reformës, duke përfshirë trajnime për profesionistët dhe përditësimin e proceseve ligjore dhe teknike. Monitorimi do të realizohet përmes krijimit të një mekanizmi të rregullt vlerësimi që do të analizojë progresin e zbatimit, do të identifikojë pengesat dhe do të sigurojë korrigjime të menjëhershme. Ky proces do të mbështetet me ndihmën e ekspertëve ndërkombëtarë dhe asistencën teknike nga BE. Shoqëritë do të duhet të sigurojnë përputhshmërinë me rregullat e konkurrencës dhe të njoftojnë Autoritetin e Konkurrencës kur ato përmbushin kriteret e përcaktuara për bashkime, për të shmangur pasojat ligjore dhe financiare që mund të lindin nga mosnjoftimi.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Duke nisur prej muajit maj 2008, themelimi, organizimi dhe drejtimi i organizatave të biznesit në Shqipëri rregullohet me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (ligji për shoqëritë tregtare). Në vitin 2011 Kuvendi i Shqipërisë miratoi një ndryshim në ligjin për shoqëritë tregtare, me qëllim përshtatjen e nivelit të kapitalit minimal të shoqërive aksionare, me kërkesat e Direktivës së Dytë të BE-së mbi Ligjin 9901/2008. Në vitin 2014, me qëllim harmonizimin e mëtejshëm me direktivat e reja të BE-së, Kuvendi i Shqipërisë miratoi disa shtesa dhe ndryshime të mëtejshme me karakter më thelbësor në ligjin për shoqëritë tregtare. Gjithashtu, me anë të këtyre shtesave dhe ndryshimeve synohej që të harmonizoheshin më tej dispozitat e ligjit për shoqëritë tregtare me disa akte të tjera ligjore shqiptare dhe të qartësoheshin disa çështje praktike që u hasën gjatë zbatimit të tij. Në këtë proces, shumë palë interesi nga komuniteti i biznesit dhe juristë shqiptarë morën në shqyrtim kuadrin ligjor tregtar.

Synimi i ligjit për shoqëritë tregtare ishte sanksionimi i një sistemi të thjeshtë, të qartë dhe të përditësuar, i aftë për të thithur investime të huaja dhe për të siguruar harmonizimin e dispozitave të tij me legjislacionin evropian të shoqërive tregtare, përfshirë direktivat përkatëse. Rrjedhimisht, ligji për shoqëritë tregtare pasqyron standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare lidhur me të drejtën tregtare, drejtimin e brendshëm të shoqërive tregtare dhe përgjegjësinë sociale të shoqërive tregtare. Legjislacioni evropian ndryshon shpesh, dhe për rrjedhojë, legjislacioni shqiptar duhet të ndjekë ritmin e zhvillimeve të reja në nivel evropian. Ligji shqiptar për shoqëritë tregtare i vitit 2008 përputhet me sistemet e reja rajonale të së drejtës tregtare, aspekt ky i rëndësishëm që pasqyron kërkesën për integrim rajonal dhe marrëdhënie ekonomike rajonale, parashikuar në Titullin III të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocimit (MSA) nënshkruar më 12 qershor 2006 mes BE-së, Shteteve Anëtare të BE-së dhe Shqipërisë. Në këtë aspekt, me anë të ligjit për shoqëritë tregtare synohet mundësimi i anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Harmonizimi i ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare në Shqipëri me *acquis-in* e BE-së është një nga prioritetet kyçe të procesit të integrimit të vendit në Bashkimin Evropian. Ky proces ka si objektiv sigurimin e përputhshmërisë me direktivën e BE-së, me qëllim krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm, transparent dhe efikas për zhvillimin e biznesit. Ndërsa Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim, ende ka sfida për t’u përballur.

Siç u shpjegua më sipër legjislacioni tregtar i hartuar në vitet 2007-2008 ka qenë një hap i rëndësishëm drejt harmonizimit me kërkesat e BE-së, por ende ka nevojë për ndryshime dhe plotësime për të arritur përputhshmërinë e plotë me direktivat e BE-së. Në veçanti, përputhshmëria e ligjit shqiptar me Direktivën (BE) 2017/1132 lidhur me disa aspekte të së drejtës së shoqërive tregtare (kodifikim) (Direktiva e Kodifikuar), Direktivën (BE) 2019/1151 që ndryshon Direktivën (BE) 2017/1132 sa i përket përdorimit të mjeteve dhe proceseve dixhitale në të drejtën e shoqërive tregtare (Direktiva për Mjetet Digjitale)

Procesi i integrimit të Shqipërisë në tregun e brendshëm të BE-së kërkon që vendi të krijojë një kuadër ligjor që është i harmonizuar plotësisht me rregullat dhe standardet e Bashkimit Evropian. Për këtë arsye, shumë nga këto reforma janë të mbikëqyrura nga institucionet evropiane dhe nga autoritetet shqiptare.

Sipas Raportit të Progresit 2024 të Komisionit Evropian, të publikuar më 30 tetor 2024, Shqipëria vlerësohet për përparimin në harmonizimin e ligjit 9901/2008 me *acquis-in* e BE-së nën Kapitullin 6. Komisioni rekomandon intensifikimin e përpjekjeve për përafrim të plotë me Direktivën (BE) 2017/1132, të ndryshuar, duke theksuar nevojën për të adresuar boshllëqet në operacionet ndërkufitare, përdorimin e mjeteve digjitale dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për zbatim efektiv, si pjesë e negociatave për anëtarësimin¹.

Për shembull, një ndër arritjet është Qendra Kombëtare e Biznesit është përgjegjëse për regjistrimin e shoqërive, duke mundësuar regjistrim të lirë online dhe akses në të dhëna nëpërmjet internetit. Në shkurt 2024, Qendra Kombëtare e Biznesit mori certifikimin ISO 9001:2015 për shërbimet në regjistrin e biznesit, regjistrin e licencave, autorizimeve dhe lejeve, si dhe regjistrin e pronarëve përfutues.

¹ Shih faqet 12 dhe 67 të Progress Raportit 2024.

Analiza e boshllëqeve ligjore (LGA) për Kapitullin 6 nxjerr në pah disa mangësi të rëndësishme në përafrimin e legjislacionit shqiptar me Direktivën (BE) 2017/1132, të ndryshuar nga Direktivat (BE) 2019/1151 dhe 2019/2121. Për bashkimet dhe ndarjet e brendshme, të rregulluara nën Titullin II, Kapitujt I dhe III, Ligji nr. 9901/2008 ofron një kuadër bazë për proceset kryesore, por nuk përfshin dispozitat për "operacione të tjera të trajtuara si bashkime" sipas Neneve 116-117 dhe "ndarje" sipas Neneve 158-159 të Direktivës.

Për formimin, pavlefshmërinë dhe vlefshmërinë e detyrimeve të shoqërive tregtare, të rregulluara në Titullin I, Kapitulli II, të ligjit shqiptar, kuadri ligjor është pjesërisht i përafuar, por mungon detajimi i plotë i informacionit të detyrueshëm në statutet e shoqërive me ofertë publike sipas direktivës, çka e pozicionon përafrimin si të lartë por ende jo të plotë. Në mënyrë të ngjashme, mirëmbajtja dhe ndryshimi i kapitalit, i trajtuar në Titullin I, Kapitulli IV, është pjesërisht i përafuar lidhur me kërkesat për kapitalin minimal dhe procedurat, por nuk përfshin harmonizimin me rregullat e detajuara për shpërndarjen të aksionarët dhe mbrojtjet për kreditorët, duke mbajtur të njëjtin nivel përafrimi të lartë.

Si rrjedhojë e ndërhyrjeve rregullatore dhe ligjore për përafrimin e Direktivës 2017/1132, institucionet duhet të kenë parasysh se harmonizimi me standardet e BE-së kërkon edhe disa konsiderata strategjike që duhet të ecin paralelisht me ndryshimin e Direktivës 2017/1132. Së pari, alokimi i përgjegjësisë për transpozimin e këtyre kërkesave duhet të jetë i qartë dhe i koordinuar mes institucioneve kryesore si Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Ministria e Financave dhe QKB. Koordinim do të duhet në të ardhmen edhe me institucione të tjerë në kuadër të harmonizimit të kapitujve të tjerë të Acquis, ku institucioni më i ndërlidhur është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), për të siguruar që aspekte si të drejtat e aksionarëve, transparencja dhe raportimi financiar të trajtohen në mënyrë efektive dhe të unifikuar. Së dyti, mundësimi i planifikimit të përafrimit rregullator është thelbësor, duke kërkuar që ndryshimet legjislative për shoqëritë e listuara të sinkronizohen me ndërhyrjen rregullatore të kësaj RIA, për të krijuar një kuadër koherent që adreson jo vetëm kërkesat e Direktivës 2017/1132, por edhe standardet specifike të qeverisjes korporative për shoqëritë e listuara duke forcuar mbrojtjen e aksionarëve dhe transparencën në ato akte ligjore ku këto ndryshime mund të gjejnë shtratin e tyre.

Bazuar në nenin 70 të MSA-së, Shqipëria angazhohet të bëjë përafrim gradual të kuadrit të saj rregullator me acquis të BE-së, angazhim ky i ndërmarrë dhe në kuadër të negociatave të anëtarësimit në BE. Harmonizimi i legjislacionit të shoqërive tregtare me acquis respektiv të BE-së është objekt negocimi në Kapitullin 6 të negociatave "Legjislacioni i shoqërive tregtare". Në takimin bilateral *screening*, më 3 shkurt 2023, Shqipëria shprehu angazhimin për përafrim të plotë të kuadrit të saj rregullator me acquis, ndër të tjera me Direktivën Direktivën (BE) 2017/1132, të ndryshuar nga Direktiva (BE) 2019/1151 Direktiva (BE) 2019/2121, brenda vitit 2025.

Në këtë linjë vjen dhe angazhimi i qeverisë për përafrim të plotë rregullator me acquis të BE-së i cili rishprehet në Pozicionin Negociues për Kapitullin 6 të negociatave, si pjesë e Grup kapitujve 2 – Tregu i Brendshëm, ku vendi zotohet të mbyllë negociatat teknike brenda vitit 2027.

Për zbatimin e këtyre angazhimeve ligjore e politike, në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2025-2027, MEKI parashikon masa për përafrimin rregullator të Direktivës së Kodifikuar, të ndryshuar, brenda vitit 2025, kjo me mbështetje të asistencës teknike ofruar nga Qeveria Gjermane, përmes GIZ.

Problemi në shqyrtim

1. Përshkruani natyrën e problemit.

2. *Identifikoni shkaqet e problemit.*
3. *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
4. *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
5. *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Procesi i harmonizimit të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare në Shqipëri me *acquis-in* e Bashkimit Evropian, nën Kapitullin 6, është një aspekt kyç i integritetit të Shqipërisë në BE. Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me rregulloret e BE-së është thelbësor për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, duke krijuar një mjedis të transparencës, konkurrencës dhe rritjes. Megjithatë, pavarësisht përparimeve pozitive në disa fusha, Shqipëria vazhdon të përballet me sfida të mëdha në arritjen e përputhshmërisë së plotë me kuadrin ligjor të BE-së për shoqëritë. Sipas raportit të fundit të Komisionit Evropian për vitin 2024, Shqipëria është përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e ligjit 9901/2008 tregtare. Shqipëria duhet, veçanërisht: të finalizojë rishikimin në fushën e ligjit 9901/2008 tregtare për të identifikuar ndryshimet që nevojiten për të përfunduar përputhshmërinë me *acquis-in* e BE-së dhe të bëjë përparim në adoptimin e këtyre ndryshimeve, përfshirë të ndryshimeve lidhur me përdorimin e mjeteve digjitale, bashkimeve dhe ndarjeve të shoqërive, përjashtimit të administratorëve [...].

BE ka rregulla të përbashkëta për formimin, regjistrimin dhe kërkesat e publikimit dhe transparencës në përgjithësi të një shoqërie dhe veprimtarisë së saj. Megjithëse ka një përputhshmëri të caktuar me *acquis-in* e BE-së në disa fusha të ligjit 9901/2008 dhe qeverisjes korporative, nuk është bërë përparim ligjor gjatë periudhës së raportimit.

Në kuadër të procesit të harmonizimit të legjislacionit shqiptar me *acquis-in* e Bashkimit Evropian, është thelbësore të shqyrtohet se cilat janë aspektet e ligjit shqiptar që janë në përputhje të plotë me Direktiven (BE) 2017/1132, dhe cilat janë ato që kërkojnë përshtatje të mëtejshme. Kjo do të ndihmojë për të kuptuar sfidat që Shqipëria duhet të kalojë për të siguruar që ligji i saj të jetë në përputhje të plotë me kërkesat e BE-së. Në këtë drejtim ka disa fusha ku ligji shqiptar ende nuk është plotësisht në përputhje me Direktiven (BE) 2017/1132. Kjo mospërputhje shkakton pasiguri ligjore për bizneset, duke kufizuar aftësinë e tyre për të operuar me efikasitet dhe transparencë, veçanërisht në transaksione ndërkufitare, dhe minon konkurrueshmërinë e tregut vendas. Për më tepër, ajo rrezikon përputhshmërinë me standardet e BE-së, duke penguar integritimin ekonomik dhe arritjen e objektivave të anëtarësimit deri në 2030, si dhe mbylljen e negociatave teknike brenda 2027-ës

Natyra e problemit

Duke konstatuar që natyra e problemit është e karakterit rregullator, pra mungesa e përputhjes së plotë rregullatore e legjislacionit vendas me *acquis-in* e BE-së, evidentohen disa boshllëqe kryesore. Ligji nr. 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, nuk përafron plotësisht Direktivën (BE) 2017/1132, të ndryshuar nga Direktivat (BE) 2019/1151 dhe 2019/2121..

Angazhimi për përputhje synon të përforcojë standardet e menaxhimit të brendshëm, transparencës dhe mbrojtjes së palëve të interesuara në funksionimin e shoqërive tregtare, duke avancuar më tej përputhshmërinë me kërkesat e Direktivës (BE) 2017/1132, të ndryshuar nga Direktiva (BE) 2019/2121. Së pari, duhet të parashikohet që degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive, qofshin shqiptare apo të huaja, të mund të regjistrohen edhe në distancë duke përdorur mjete elektronike komunikimi. Po ashtu, rregullohet për herë të parë mënyra e çregjistrimit të degëve në rastet kur shoqëria vendos të ndërpresë veprimtarinë ose në rastin kur shoqëria pushon së ekzistuari.

Më tej, ndryshimet duhet të përfshijnë kërkesën që, nëse një degë i përket një shoqërie të huaj, të deklarohet edhe regjistri tregtar i vendit të origjinës si dhe numri i regjistrimit të saj në atë regjistrë, duke rritur nivelin e transparencës dhe gjurmueshmërisë së subjekteve të huaja që operojnë në territorin shqiptar.

Një ndër risitë më të rëndësishme lidhet me ndalimin për të qenë përfaqësues ligjorë, administratorë ose anëtarë të këshillave të administrimit të shoqërive tregtare, të personave që janë dënuar në një shtet tjetër për vepra që korrespondojnë me veprat penale sipas ligjit shqiptar, si dhe ndaj personave që janë subjekt i një mase ndaluese për ushtrimin e një profesioni të lidhur me aktivitetin e shoqërisë. Në këtë kuadër, parashikohet detyrimi që çdo person i emëruar si administrator të nënshkruajë një deklaratë të posaçme, ku konfirmon se nuk është subjekt i ndalimeve të mësipërme. Këto të dhëna do të administrohen në një regjistrë të dedikuar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, i cili do të përditësohet dhe menaxhohet sipas një udhëzimi të ministrit përgjegjës për ekonominë.

Ndryshimet duhet të përfshijnë edhe një shtesë për mënyrën e përdorimit të fitimit dhe kthimin e pagesave të paautorizuara të bëra në favor të aksionarëve. Këto dispozita ndalojnë shpërndarjen e fitimit nëse pasuria neto e shoqërisë bie nën kufirin minimal të kapitalit dhe rezervave të padisponueshme për shpërndarje. Aksionarët që kanë përfituar pagesa në kundërshtim me ligjin detyrohen t'i kthejnë ato, përveçse nëse provojnë se kanë vepruar me mirëbesim dhe fondet nuk janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve. Pra ligji gjithashtu ka ende nevojë për përshtatje më tej të rregullave (dhe kufizimeve) për shpërndarjen e fitimit, si dhe blerjen e aksioneve të veta dhe raportin vjetor në rastin e blerjes së aksioneve të veta (në rastet e parashikuara nga ligji), dhe mekanizmat e miratimit për transaksionet sipas nenit 64 të Direktivës.

Gjithashtu, duhet rregullohet më qartë çështja e zotërimit të aksioneve të veta nga shoqëria. Shoqëria që zotëron aksione të veta duhet të krijojë një rezervë të veçantë që nuk mund të shpërndahet dhe të raportojë në pasqyrat vjetore arsyet e blerjes, numrin, vlerën dhe përqindjen e këtyre aksioneve ndaj kapitalit të nënshkruar. Po ashtu, për herë të parë rregullohet edhe rasti kur aksionet e veta pranohen si garanci për një detyrim të një pale të tretë, duke përcaktuar se mbi to zbatohen të gjitha kufizimet që vlejnë për blerjen e aksioneve të veta. Një tjetër nevojë për harmonizim është ndalimi që shoqëria të japë kredi, të garantojë ose të sigurojë hua për qëllime të blerjes së aksioneve të veta, përveç rasteve kur ajo vepron si institucion financiar dhe vetëm në kushtet e tregut. Edhe në këto raste, kërkohet që organi drejtues të hartojë një raport të posaçëm, që t'i paraqitet asamblesë së përgjithshme.

Në vijim duhet parashikohet një dispozitë e re mbi pavlefshmërinë e bashkimit, e cila përcakton qartë rastet në të cilat një bashkim i regjistruar mund të shpallet i pavlefshëm me vendim gjyqësor. Kufizimi i afatit për paraqitjen e padisë për pavlefshmëri brenda 6 muajve nga regjistrimi i bashkimit dhe mundësia e dhënies së afatit për korrigjimin e parregullsive përpara shpalljes së pavlefshmërisë, synojnë të garantojnë sigurinë juridike dhe stabilitetin e transaksioneve.

Në përfundim, ndryshimet synojnë të përmirësojnë cilësinë e qeverisjes korporative, të sigurojnë përputhshmëri më të madhe me kërkesat e të drejtës së BE-së dhe të rrisin besimin e palëve të treta në veprimtarinë dhe strukturën juridike të shoqërive tregtare në Shqipëri.

Kjo mos përputhshmëri sjell pasiguri ligjore për bizneset dhe investitorët, duke penguar krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe konkurrues. Gjithashtu, ajo rrezikon mosarritjen e objektivave për anëtarësimin në BE deri në 2030 dhe mbylljen e negociatave teknike brenda 2027-ës, duke vështirësuar integrimin e plotë të Shqipërisë në tregun e brendshëm evropian.

Shkaqet e problemit

Shkaqet e këtij problemi mund të kategorizohen sipas tipologjisë së mëposhtme, duke filluar me mos përputhjet rregullatore si shkaku primar.

Së pari, diferencat mes Direktivës (BE) 2017/1132, të ndryshuar nga Direktivat (BE) 2019/1151 dhe 2019/2121, dhe ligjit shqiptar përbëjnë një sfidë kryesore.

Së dyti, ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, në formën e tij aktuale, nuk përmban dispozita të plota dhe të përditësuara që reflektojnë zhvillimet më të fundit në të drejtën e shoqërive të Bashkimit Evropian, veçanërisht ato që lidhen me qeverisjen e brendshme, transparencën financiare, përjashtimet nga funksionet drejtuese dhe mbrojtjen e kreditorëve dhe investitorëve. Mungesa e dispozitave të tilla krijon hapësira për pasiguri ligjore dhe rreziqe të shtuar për palët e interesuara, përfshirë investitorët, punëmarrësit dhe partnerët tregtarë të shoqërive. Për shembull, mungon një bazë e saktë ligjore për ndalimin e personave të dënuar në shtete të tjera të BE-së për vepra të ngjashme penale nga funksionet drejtuese në shoqëri; nuk parashikohet kthimi i detyrueshëm i fitimeve të shpërndara në mënyrë të paligjshme; dhe trajtimi i aksioneve të veta ose i mbështetjes financiare për blerjen e tyre është i paplotë ose i paqartë.

Gjithashtu, kuadri aktual nuk ofron rregullim të mjaftueshëm për çështje të tilla si pranimi i aksioneve të veta si garanci, transparenca në pasqyrat financiare për transaksionet mbi aksione të veta, apo pavlefshmëria e bashkimeve në raste të cenimit të ligjshmërisë procedurale. Në mungesë të këtyre mekanizmave mbrojtës dhe sanksionues, tregu shqiptar mund të përballet me praktika të dëmshme të keqqeverisjes korporative, rrezik të pastrimit të fondeve, si dhe mungesë besimi nga investitorët vendas dhe të huaj.

Ndaj, këto boshllëqe dhe paqartësi në ligjin ekzistues e bëjnë të domosdoshëm ndërhyrjen përmes amendimeve të propozuara, të cilat garantojnë jo vetëm harmonizimin me acquis të BE-së, por edhe një mjedis më të sigurt, më të përgjegjshëm dhe më transparent për ushtrimin e aktivitetit tregtar në Shqipëri.

Edhe pse nuk është objekt shqyrtimi apo analize në kuadër të kësaj RIA apo ndryshimeve ligjore që do të vijnë përmes kësaj RIA, një aspekt që duhet konsideruar, është nevoja që MEKI, në kuadër të negociatave të kapitullit 19, të bëjë një përshtatje më e thellë për mbrojtjen e palëve të përfshira (p.sh. punonjësve), sipas Direktivës 2001/23/KE, e cila është përshtatur vetëm pjesërisht përmes disa dispozitave në Kodin e Punës, kur kjo Direktivë të negociohet dhe transpozohet në ligjin shqiptar.

Shtirja e problemit

Problemi ka një shtirje të gjerë, duke prekur të gjitha shoqëritë tregtare në Shqipëri, veçanërisht ato të angazhuara në operacione ndërkufitare, bashkime dhe ndarje. Sipas raportit të INSTAT për 2023, nga 226,778 njësiti ligjore aktive, 28,292 SHPK dhe 716 SHA mund të ndikohen drejtpërdrejt nga mungesa e harmonizimit. Kjo situatë sjell pasoja ekonomike duke përfshirë reduktimin e investimeve të huaja për shkak të pasigurisë ligjore dhe rritjen e barrës administrative për bizneset, sidomos NVM-të, të cilat përbëjnë 86.2% të ndërmarrjeve aktive dhe vuajnë nga kosto shtesë për përshtatje me standarde të paplota.

Për të siguruar harmonizimin e plotë me Direktiva 2017/1132 dhe për të adresuar çështjet e ngritura, ndërhyrjet rregullatore duhet të bëhen në një masë të plotë që siguron harmonizimin e plotë të ligjit shqiptar me kërkesat e BE-së. Kjo do të kërkojë përditësimin dhe ndryshimin e ligjit ekzistues, duke plotësuar boshllëqet dhe duke përshtatur rregullat dhe procedurat për të përmbushur standardet e reja të kërkuara nga Direktiva. Përshtatjet duhet të bëhen në disa nivele siç është përshkruar në nën seksionin shkaqet e problemit.

Në përgjithësi, ndërhyrjet duhet të bëhen në një masë të plotë që i mundëson Shqipërisë të përmbushë plotësisht kërkesat e BE-së, duke i sjellë ato në legjislacionin aktual, pa krijuar ndryshime të panevojshme të strukturës ligjore të vendit. Ky proces duhet të përfshijë konsultime të vazhdueshme me aktorët e përfshirë, duke siguruar që ligji të jetë funksional dhe në përputhje me kërkesat e BE-së për transparencë, siguri dhe mundësi për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Grupet kryesore që preken nga ky problem janë:

Grupet kryesore të prekura nga mungesa e harmonizimit me Direktivën (BE) 2017/1132 mund të grupohen si më poshtë për të pasqyruar ndikimin e gjerë të këtij problemi.

Së pari, ndikimi institucional i amendimeve në Ligjin nr. 9901/2008 është i ndjeshëm dhe shumëplanësh, pasi kërkon ndërhyrje të reja në funksionimin, mbikëqyrjen dhe bashkërendimin ndërinstitucional të disa organeve publike. Më poshtë përshkruhen efektet kryesore:

- Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) do të përballët me detyrime të reja operative, përfshirë: krijimin dhe administrimin e një regjistri të personave të ndaluar për funksione drejtuese, verifikimin e deklaratave të vetëdeklarimit të administratorëve të rinj, si dhe mbajtjen e të dhënave shtesë për degët e huaja dhe raportet e shoqërive mbi zotërimin e aksioneve të veta. Kjo kërkon zhvillim të moduleve të reja digjitale dhe rritje të kapaciteteve teknike dhe njerëzore për përpunimin e informacionit.
- Ministria përgjegjëse për ekonominë duhet të nxjerrë një udhëzim të detajuar për mënyrën e mbajtjes dhe përdorimit të regjistrit të ndalimeve (që do të administrohet nga QKB), si dhe të mbikëqyrë përputhshmërinë e këtij sistemi me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe institucionet financiare shtetërore mund të përfshihen në vlerësimin e pasojave të shpërndarjeve të fitimit dhe transaksioneve që lidhen me blerjen ose garantimin e aksioneve të veta, për të identifikuar rreziqet fiskale, shmangien e tatimeve ose rritjen e përgjegjësisë financiare të administratorëve.
- Gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm do të kenë kompetencë të re për të shqyrtuar çështjet e pavlefshmërisë së bashkimit dhe do të duhet të aplikojnë afate dhe standarde të reja procedurale. Kjo kërkon trajnime të posaçme për gjyqtarët në fushën e së drejtës tregtare evropiane dhe për interpretimin e kufizuar të ndërhyrjes *ex post* në transaksione të regjistruara.
- Në përgjithësi, ndikimi institucional do të kërkojë investim në kapacitete njerëzore, sisteme IT, protokolle bashkëpunimi ndërinstitucional dhe udhëzime të zbatueshme administrative, për të siguruar zbatim të qëndrueshëm dhe në përputhje me objektivat e transpozimit të *acquis communautaire*.

Së dyti, bizneset, me një vëmendje të veçantë ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), preken drejtpërdrejt nga ky problem. Shoqëritë tregtare do të duhet të përshtatin praktikën e tyre me dispozitat e reja, duke përfshirë raportimet vjetore më të detajuara, kontrollin paraprak mbi gjendjen financiare përpara shpërndarjes së fitimit dhe përmbushjen e standardeve për vetëdeklarim nga administratorët. Megjithatë, NVM-të, të cilat përbëjnë një pjesë të madhe të ekonomisë shqiptare, mund të përballen me sfida në përshtatjen me kërkesat e reja rregullatore për shkak të burimeve të kufizuara financiare dhe administrative, duke e bërë mbështetjen institucionale të domosdoshme për to.

Së treti, shoqëria civile, përfshirë shoqatat e biznesit, është një grup tjetër i prekur që meriton vëmendje. Këto organizata luajnë një rol të rëndësishëm në përfaqësimin e interesave të bizneseve dhe mund të ndikohen nga mungesa e qartësisë ligjore, duke pasur vështirësi në këshillimin e anëtarëve për operacione të tilla si bashkimet apo ndarjet. Për më tepër, ato mund të shërbejnë si urë lidhëse mes qeverisë dhe sektorit privat për të nxitur dialogun dhe për të lehtësuar zbatimin e reformave.

Së katërti, qytetarët që dëshirojnë të hapin shoqëri tregtare preken gjithashtu nga ky problem. Ndryshimet ligjore të parashikuara mund të prekin individët që synojnë të krijojnë biznese, të cilët mund të hasin pengesa (për shkak të njohurive të kufizuara) në proceset e regjistrimit, qasjen në informacion dhe përdorimin e procedurave digjitale, gjë që mund të dekurajojë sipërmarrjen dhe të vonojë nismat e tyre ekonomike, veçanërisht në një kontekst ndërkufitar.

Sipas të dhënave të disponueshme në Raportin e Regjistrave të Biznesit përgatitur nga INSTAT për vitin 2023, është përgatitur dhe një analizë ndikimi bazuar në të dhënat aktuale të shoqërive në Shqipëri.

Në vitin 2023, në Shqipëri janë 226,778 njësitë ligjore aktive, që përfshijnë një gamë të gjerë entitetesh, si Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar Shoqëritë Aksionare dhe forma të tjera ligjore. Prej këtyre, gjithsej 28,292 janë SHPK dhe 716 janë SHA. Entitetet e tjera ligjore janë të klasifikuara në forma të ndryshme, siç janë entitetet publike, OJQ-të dhe struktura të tjera jo-korporative.

Nga 130,338 ndërmarrje aktive (përfshirë fermerët), shumica janë ndërmarrje të vogla: 86.2% e tyre janë "prodhues të shërbimeve", përfshirë industrinë e tregtisë (44,267), akomodimin dhe shërbimet e ushqimit (17,962), dhe shërbime të tjera (38,299). Numri i ndërmarrjeve të mëdha (me më shumë se 50 punonjës) është relativisht i vogël, duke përbërë vetëm 1.6% të totalit, por ato punësojnë 50% të forcës së punës dhe gjenerojnë 45.3% të xhiros totale. Kjo tregon se, megjithëse shumica e ndërmarrjeve janë të vogla në madhësi, ato të mëdha kontribuojnë disproporcionalisht në ekonomi.

Shoqëritë do të duhet të përditësojnë statutet dhe dokumentet e tyre organizative për të siguruar që ato përputhen me kërkesat e reja. Ato do të duhet të zbatojnë masa shtesë transparence në lidhje me të drejtat e aksionarëve dhe qeverisjen korporative. Implementimi i mjeteve digjitale për njoftimet nëpërmjet sistemeve të ndërlidhjes do duhet të sjellin përshtatje të sistemit të mbajtur nga QKB.

Një tjetër ndikim vlerësohet për qëllime të konkurrencës, veçanërisht për transaksionet e bashkimeve dhe blerjeve. Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar parashikon se, nëse shoqëritë e bashkuara përmbushin nivelet e xhirove apo nivelet e tjera të caktuara në lidhje me pjesën e tregut dhe të ardhurat, ato duhet të njoftojnë Autoritetin e Konkurrencës për miratimin e transaksionit. Autoriteti do të vlerësojë ndikimin e bashkimit në konkurrencë, duke u fokusuar te mundësia që ky bashkim të krijojë ose forcojë një pozicion dominues që mund të prishë konkurrencën në treg. Këto rregulla do të ndikojnë jo vetëm te shoqëritë që operojnë brenda tregut të brendshëm, por edhe te ato që janë të përfshira në operacione ndërkufitare, duke kërkuar që të përputhen me kërkesat e bashkimit dhe konkurrencës të harmonizuara me rregullat e BE-së. Kjo do të kërkojë që shoqëritë të sigurojnë përputhshmërinë me rregullat e konkurrencës dhe të njoftojnë Autoritetin e Konkurrencës kur ato përmbushin kriteret e përcaktuara për bashkime, për të shmangur pasojat ligjore dhe financiare që mund të lindin nga mosnjoftimi.

Vlerësimi i mundësisë për të trajtuar problemin përmes një ndryshimi të politikave

Ky problem mund të trajtohet vetëm përmes ndryshimit të politikave, veçanërisht duke miratuar ligje dhe rregullore që do të adresojnë boshllëqet ligjore ekzistuese dhe do të krijojnë një mjedis ligjor të harmonizuar plotësisht me standardet e BE-së, detyrim ky sipas nenit 70 të MSA-së. Prandaj, trajtimi i këtij problemi kërkon domosdoshmërisht ndërhyrje rregullatore, si e vetmja mënyrë për të adresuar natyrën e tij dhe për të arritur harmonizimin me standardet e BE-së. Ndryshimi rregullator është i nevojshëm në dy drejtime kryesore. Së pari, politikisht, ai përfaqëson një angazhim të marrë në kuadër të negociatave të anëtarësimit në BE, ku përafrimi me *acquis-in*, përfshirë Direktivën (BE) 2017/1132, është një prioritet për mbylljen e Kapitullit 6 dhe avancimin e procesit të integritimit. Së dyti, ligjërisht, ky ndryshim rrjedh nga detyrimet e përcaktuara në Nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), e cila angazhon Shqipërinë për të harmonizuar gradualisht legjislacionin vendas me atë të BE-së. Prandaj, miratimi i ligjeve dhe rregulloreve të reja për të mbyllur boshllëqet ligjore ekzistuese duke përfshirë rregulla që forcojnë transparencën, mbrojnë të drejtat e aksionarëve dhe nxisin qeverisjen korporative të qëndrueshme përbën bazën e vetme për zgjidhjen efektive të problemit dhe krijimin e një mjedisi ligjor plotësisht të përafruar me standardet evropiane.

Megjithatë, masa të tjera plotësuese jorregullore mund të mbështesin këtë proces, pa mundur të zëvendësojnë ndërhyrjen rregullatore. Për shembull, organizimi i trajnimeve për profesionistët ligjorë dhe punonjësit e institucioneve si Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) apo MEKI-t mund të rrisë kapacitetet për të kuptuar dhe zbatuar kërkesat komplekse të Direktivës. Po ashtu, ofrimi i mbështetjes teknike dhe programeve trajnuese për bizneset dhe zyrtarët mund të lehtësojë përshtatjen me rregullat e reja dhe të përshpejtojë zbatimin praktik të reformave. Fushatat e ndërgjegjësimit publik dhe për bizneset, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), mund të rrisin njohuritë për përfitimet e një kuadri ligjor të harmonizuar. Konsultimet me palët e interesuara, si shoqatat e biznesit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, mund të ndihmojnë në identifikimin e nevojave specifike dhe në përshtatjen e zbatimit të rregullave të reja për të minimizuar sfidat praktike, duke krijuar një proces më gjithëpërfshirës dhe të mbështetur. Gjithashtu, ofrimi i asistencës teknike përmes bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë si GIZ ose institucione të BE

së mund të mbështesë zhvillimin e infrastrukturës digjitale të QKB-së dhe përmirësimin e aftësive administrative për të plotësuar standardet teknike të ndërlidhjes me sistemin BRIS.

Këto masa, ndonëse të dobishme për të adresuar sfidat e mbetura dhe për të përmirësuar efikasitetin, mbeten dytësore dhe nuk mund të kompensojnë mungesën e një kuadri ligjor të plotë dhe të zbatueshëm, i cili mbetet thelbësor për zgjidhjen përfundimtare të problemit..

Arsyeja e ndërhyrjes

6. *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
7. *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
8. *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
9. *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Arsyeja për Ndërhyrje

Nisur nga problematikat e evidentuara më sipër, lind domosdoshmëria e ndërhyrjes së qeverisë për të ndryshuar dhe plotësuar kuadrin ligjor, duke trajtuar boshllëqet që kërkojnë një rregullim më të plotë për të arritur harmonizimin e plotë me acquis-in e BE-së. Qeveria e Shqipërisë e konsideron këtë ndërhyrje të nevojshme jo vetëm për të përmbushur detyrimet ligjore dhe politike, por edhe si parakusht për mbylljen e negociatave teknike me Bashkimin Evropian për Kapitullin 6 brenda vitit 2027, siç parashikohet në Pozicionin Negociues për këtë kapitull të miratuar në Janar 2025, dhe për anëtarësimin e vendit në BE brenda vitit 2030, datë kjo e përcaktuar si objektiv në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2030.

Ky harmonizim rregullator është thelbësor për të siguruar përputhshmëri të plotë me kërkesat e Direktivës (BE) 2017/1132 dhe për të përmirësuar mjedisin e biznesit në Shqipëri. Përparimi në këtë drejtim do të rrisë besimin e investitorëve vendas dhe të huaj, do të forcojë transparencën në operacionet e shoqërive tregtare dhe do ta bëjë Shqipërinë një destinacion më tërheqës për investime të huaja të drejtpërdrejta, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë e tregut. Pavarësisht përpjekjeve të deritanishme për përafrim me standardet e BE-së, boshllëqet e mbetura, të identifikuar në kuadrin ligjor aktual, e bëjnë të domosdoshme ndërhyrjen e qeverisë për të adresuar këto sfida dhe për të vendosur një sistem ligjor të qëndrueshëm, të drejtë dhe plotësisht të integruar me tregun e brendshëm evropian, në përputhje me angazhimet e marra në procesin e integrimit. Ky harmonizim është thelbësor për rritjen e besimit të investitorëve, për të përmirësuar transparencën dhe për të mundësuar që Shqipëria të jetë një destinacion tërheqës për investime të huaja të drejtpërdrejta. Pavarësisht përpjekjeve të bëra deri tani, ende ka boshllëqe të cilat e bëjnë të nevojshme ndërhyrjen e qeverisë për të adresuar këto sfida dhe për të siguruar një sistem të qëndrueshëm, konkurrues dhe të drejtë për bizneset dhe qytetarët.

Çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje

Qeveria synon të trajtojë disa çështje kyçe nëpërmjet harmonizimit të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Këto përfshijnë boshllëqet ligjore që nga kërkesat për themelimin e shoqërive, pavlefshmërinë e themelimit dhe detyrimet e tjera të lidhura me to, publikimin informacioni e deri tek bashkimet, shndërrimet dhe ndarjet apo përmirësimin e qeverisjes korporatave.. Po ashtu, ndërhyrja synon të mundësojë një sistem të qartë dhe të parashikueshëm ligjor që mbështet zhvillimin ekonomik dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

Më konkretisht, ligji nr. 9901/2008 rregullon themelimin dhe pavlefshmërinë e shoqërive, por mungesa e harmonizimit me kërkesat për informacion të detyrueshëm në statutet e shoqërive publike dhe kushtet për anulimin e tyre, siç përcaktohet nga Direktiva, sjell pasiguri juridike gjatë procesit të formimit të bizneseve. Për bashkimet dhe ndarjet kombëtare, ky ligj trajton procedurat bazë, por nuk përkthen plotësisht dispozitat për "bashkimet përmes blerjes" dhe "bashkimet përmes krijimit të një shoqërie të re," duke lënë hapësirë për pasiguri ligjore që prek funksionimin e tregut të brendshëm.

Si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë

Kjo ndërhyrje mbështet objektivat e nivelit të lartë të qeverisë për integrimin në Bashkimin Evropian dhe krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe konkurrues për zhvillimin ekonomik. Harmonizimi i ligjit 9901/2008 me *acquis-in* e BE-së është një hap kyç për të siguruar që Shqipëria të përmbushë kriteret e kërkuara për anëtarësim në BE dhe për të rritur pozicionin e saj në tregjet ndërkombëtare. Harmonizimi realizohet duke u mbështetur në disa dokumente strategjike kyçe:

- **Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA):** Sipas Nenit 70 të MSA-së, Shqipëria është e detyruar të përafrojë gradualisht legjislacionin e saj me atë të BE-së. Kjo ndërhyrje rregullatore plotëson këtë kërkesë duke harmonizuar legjislacionin e shoqërive tregtare me Direktivën (BE) 2017/1132, duke forcuar kështu bazën ligjore për anëtarësimin në BE.
- **Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2025-2027:** Harmonizimi me *acquis-in* e BE-së është një prioritet i përcaktuar në PKIE, veçanërisht për mbylljen e Kapitullit 6 të negociatave me BE brenda vitit 2027. Kjo ndërhyrje është një hap konkret drejt përmbushjes së këtij objekti, duke avancuar negociatat teknike dhe përgatitjen për tregun e brendshëm evropian.
- **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2030:** Kjo ndërhyrje mbështet vizionin afatgjatë të SKZHI 2030 për anëtarësimin e Shqipërisë në BE deri në vitin 2030. Duke përafuar standardet rregullatore me ato të BE-së, ajo siguron që vendi të jetë i gatshëm për integrimin e plotë në tregun evropian, duke kontribuar në stabilitetin dhe prosperitetin ekonomik.
- **Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2025-2030:** Sipas këtij dokumenti, të hartuar në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe të miratuar nga Këshilli i Ministrave, ndërhyrja rregullatore përkon me qëllimin për të stimuluar rritjen e ekosistemit të startup-eve dhe për të zhvilluar sektorët me prioritet ekonomik si turizmi, energjia, bujqësia dhe ICT/BPO. Kjo strategji synon të rrisë produktivitetin dhe konkurrueshmërinë e këtyre sektorëve duke mbështetur sipërmarrjen inovative, dhe harmonizimi i ligjit 9901/2008 tregtare me BE-në—përfshirë modernizimin digjital dhe operacionet ndërkufitare—fuqizon bizneset shqiptare për të çelur tregje të reja dhe për të konkurruar në nivel ndërkombëtar, duke përshpejtuar rrugëtimin drejt BE-së 2030.
- **Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve (BIDS):** Në linjë me objektivat e saj për të përmirësuar klimën e biznesit, kjo ndërhyrje nxit zhvillimin e sektorit privat përmes forcimit të qeverisjes korporative dhe mbrojtjes së të drejtave të aksionarëve, duke e bërë Shqipërinë më tërheqëse për investime të huaja të drejtpërdrejta dhe duke mbështetur rritjen ekonomike.

Duke harmonizuar legjislacionin me standardet e BE-së, kjo ndërhyrje jo vetëm që përmbush kërkesat për integrim evropian, por edhe krijon mundësi të reja për investime dhe inovacion, veçanërisht për startup-et dhe sektorët strategjikë të identifikuar në Strategjinë e Sipërmarrjes Inovative. Ajo rrit konkurrueshmërinë e ekonomisë shqiptare duke lehtësuar qasjen në tregjet ndërkombëtare dhe duke forcuar stabilitetin ekonomik, në përputhje të plotë me prioritetet e qeverisë për zhvillim dhe integrim afatgjatë.

Punën ekzistuese që është realizuar tashmë

Në kuadër të përpjekjeve për harmonizimin Shqipëria ka miratuar disa ligje dhe rregullore që kanë hedhur themelet e procesit të harmonizimit duke u fokusuar në forcimin e qeverisjes korporative, transparencës dhe efikasitetit operacional. Këto reforma janë të shoqëruara nga një strategji konkrete digjitalizimi që ka si qëllim modernizimin e shërbimeve publike, përfshirë procesin e regjistrimit të bizneseve.

Reformat kryesore ligjore konsistojnë në:

Ligji 9901/2008, i ndryshuar në vitin 2014: Ky ligj themelor vendosi një kornizë ligjore moderne për shoqëritë në Shqipëri, duke futur dispozita për qeverisjen korporative, të drejtat e aksionarëve dhe raportimin financiar. Ai hapi rrugën për përshtatjen e ligjit kombëtar për shoqëritë me direktivat e BE-së,

ndërsa tani ligji do të preket me fokus kryesor reformat dhe shtesat që janë sjellë nga Direktiva e kodifikuar 2017/1132

Digitalizimi i regjistrimit të bizneseve

Në përputhje me reformat legislative, Shqipëria ka bërë përparime të rëndësishme në digitalizimin e shërbimeve publike, veçanërisht në regjistrimin e bizneseve:

Portali e-Albania: I nisur në vitin 2014, portali e-Albania shërben si një platformë e centralizuar për aksesimin e shërbimeve publike. Ai u mundëson bizneseve të regjistrohen, të dërgojnë dokumente dhe të aksesojnë shërbime të ndryshme online, duke reduktuar nevojën për vizita fizike dhe rritur efikasitetin.

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB): QKB ka luajtur një rol kyç në digjitalizimin e proceseve të regjistrimit të bizneseve. Që nga dhjetori i vitit 2014, ajo ofron shërbime regjistrimi online, duke reduktuar ndjeshëm kohën e procesimit dhe ngarkesat administrative. Në vitin 2022, u bënë mbi 787,800 aplikime për 178 shërbime biznesi përmes QKB. Në shkurt të vitit 2024, Qendra Kombëtare e Biznesit mori certifikimin ISO 9001:2015 për shërbimet në regjistrin e bizneseve, regjistrin e licencave, autorizimeve dhe lejeve, dhe regjistrin e pronarëve të vërtetë. Ky certifikim thekson angazhimin e QKB për cilësi dhe efikasitet në ofrimin e shërbimeve.

Në kuadër të përpjekjeve për harmonizimin me *acquis-in* e BE-së për Kapitullin 6, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), në bashkëpunim me Grupin Negociator të Integritimit Evropian, ka ndërmarrë punë të rëndësishme për të avancuar procesin e harmonizimit të legjislacionit të shoqërive tregtare, duke u mbështetur në analizat e detajuara si Vlerësimi i Boshllëqeve Legjislative (LGA), Vlerësimi i Boshllëqeve Institucionale dhe Administrative (IAGA), dhe Vlerësimi i Ndikimit të Politikave (PIA) për Qeverisjen Korporative të Shoqërive të Listuara..

LGA: LGA-ja, identifikon boshllëqe mes legjislacionit shqiptar dhe Direktivës 2017/1132, duke treguar përafrim të mirë por mangësi në çështjet e përmendura përgjatë kësaj RIA, si dhe nevojën për harmonizim të plotë, duke propozuar ndërhyrje legislative për përmbushjen e standardeve të BE-së.

IAGA: IAGA-ja thekson nevojën për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative për interpretimin, transpozimin, zbatimin dhe monitorimin e ligjit të BE-së për shoqëritë, duke përfshirë krijimin e kushteve për formimin online të shoqërive, përmirësimin e funksionalitetit të regjistrit kombëtar, dhe trajnimet për institucionet, si dhe pavarësinë financiare të organeve të mbikëqyrjes së auditimit, duke ofruar një udhërrëfyes për zbatimin efektiv të *acquis-it*.

Vlerësimi i Ndikimit të Politikave (PIA): i hartuar nga MEKI dhe GNIE, ofron një analizë ndërsektoriale të çështjeve të Kapitullit 6, duke u fokusuar në harmonizimin e qeverisjes korporative për shoqëritë e listuara me *acquis-in* e BE-së, si Direktiva 2007/36/EC (SRD I), Direktiva 2017/828 (SRD II), dhe Direktiva 2022/2381 për balancën gjinore në bordet e shoqërive të listuara. PIA identifikon boshllëqe në legjislacionin shqiptar, si mungesa e rregullave për ndërmjetësit financiarë dhe politikat e angazhimit të aksionarëve, dhe propozon opsione si amendimi i Ligjit për Tregjet e Kapitalit dhe miratimi i një Kodi të Qeverisjes Korporative për shoqëritë e listuara deri në 2028, duke përfshirë institucionet si Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF). Ky dokument plotëson LGA-në dhe IAGA-në duke ofruar një analizë specifike për shoqëritë e listuara, duke evidentuar nevojën për koordinim mes MEKI dhe AMF-së për të adresuar mangësitë e identifikuara. PIA gjithashtu vlerëson ndikimet ekonomike dhe administrative, duke theksuar përfitimet për konkurrueshmërinë dhe investimet e huaja, dhe propozon një udhërrëfyes me afate për harmonizim deri në 2025-2028.

Objektivi i politikës

1. *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
2. *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*

3. *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivi i politikës për harmonizimin e ligjit 9901/20089901/2008 me *acquis-in* e BE-së është përafrimi i plotë me standardet evropiane, siç përcaktohet në Direktivën (BE) 2017/1132 dhe amendimet e saj, për të avancuar negociatat teknike të Kapitullit 6 dhe për të mundësuar anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Ky harmonizim synon të përmirësojë transparencën dhe efikasitetin e veprimtarive të ndërmarrjeve përmes rregullave konform BE-së për krijimin, regjistrimin dhe publikimet e detyrueshme, duke lehtësuar dhe mundësuar operacionet vendase dhe ndërkufitare të shoqërive tregtare. Përmes zhvillimit të një kuadri ligjor të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm, politika garanton siguri juridike për investitorët, aksionarët, kreditorët dhe palët e tjera të përfshira, duke forcuar mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe duke promovuar qeverisjen korporative.

Në nivel makro, objektivat e RIA-s përqendrohen në përafrimin e plotë të ligjit 9901/20089901/2008 me *acquis-in* e BE-së, veçanërisht me Direktivën (BE) 2017/1132 dhe amendimet e saj, për të nxitur progresin në negociatat e Kapitullit 6 dhe për të përmbushur kushtet për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, duke ndërtuar një kuadër ligjor të qëndrueshëm dhe transparent që lehtëson veprimtaritë vendase dhe ndërkufitare të bizneseve. Kjo përfshin harmonizimin e rregullave për formimin, regjistrimin dhe publikimet e detyrueshme të shoqërive për të rritur transparencën dhe efikasitetin operacional, si dhe për të thjeshtuar proceset administrative, duke nxitur sipërmarrjen dhe konkurrueshmërinë në treg. Përmes forcimit të qeverisjes korporative dhe mbrojtjes së të drejtave të aksionarëve, kreditorëve dhe investitorëve, RIA synon të garantojë siguri juridike për të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë aksionarët e pakicës, dhe të krijojë një mjedis biznesi tërheqës për investime të huaja.

Ligji duhet të harmonizohet me standardet e BE-së për të siguruar lëvizjen e lirë të kapitalit, mallrave, shërbimeve dhe personave, si dhe për të krijuar një kuadër ligjor transparent për shoqëritë që operojnë në BE. Kjo do të lehtësojë operacionet ndërkufitare dhe krijimin e shoqërive nën rregulla të qarta dhe të hapura. Përshtatja me ligjin të BE-së do të ndihmojë Shqipërinë të krijojë një mjedis ligjor të njëjtë me shtetet anëtare të BE-së, duke siguruar që shoqëritë të mund të operojnë më lirshëm dhe efikasht përtej kufijve. Shqipëria duhet të harmonizojë ligjet e saj për të promovuar lëvizjen e lirë të kapitalit dhe mallrave, duke krijuar një mjedis ligjor më të parashikueshëm dhe transparent për bizneset. Ndërhyrjet ligjore që do të pasojnë RIAN do të thjeshtojë proceset e formimit të shoqërive, regjistrimit dhe mirëmbajtjes duke harmonizuar kuadrin rregullator të Shqipërisë me standardet e BE-së. Qëllimi është të reduktohen pengesat administrative për bizneset, duke bërë më të lehtë krijimin dhe operimin e shoqërive, dhe duke inkurajuar sipërmarrjen.

Objekti qendror ka krijimi i rregullave të qarta dhe transparente për shpalljen e informacionit, duke siguruar që investitorët dhe palët e tjera të kenë akses në informacion të besueshëm. Në këtë drejtim duhet të adresohet nevoja për më shumë digjitalizim të regjistrimit të shoqërive dhe ndërveprueshmërinë e regjistrave të biznesit për shkëmbimin efikas të informacionit ndërmjet regjistrave dhe lehtësimin e transaksioneve ndërkufitare brenda BE-së.

Ndërhyrjet duhet të sigurojnë që të reduktojnë pengesat për konkurrencën dhe të nxisin një fushë loje më të barabartë për shoqëritë që operojnë në Shqipëri dhe në BE. Kjo përfshin forcimin e mbrojtjes së aksionarëve dhe palëve të tjera të interesuara, duke parandaluar abuzimet dhe duke siguruar praktika të ndershme dhe transparente të biznesit. Këto objektiva të politikës janë të përputhshme me ato të paraqitura në përmbledhjen ekzekutive të RIA-s, por janë më të detajuara dhe specifike. Kjo do të ndihmojë në përcaktimin e hapave të nevojshëm për përmbylljen e reformave ligjore dhe institucionalizimin e përputhshmërisë me direktivat e BE-së.

Sigurimi që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë

Objektivat e këtij projektligji janë konceptuar dhe strukturuar sipas parimit SMART, me qëllim që të jenë të qartë, të zbatueshëm dhe të monitorueshëm në praktikë.

Së pari, objektivat janë specifike, pasi secila ndërhyrje synon adresimin e një boshllëku konkret në kuadrin ekzistues të Ligjit nr. 9901/2008: ndalimi i personave të papërshtatshëm për funksione drejtuese, rregullimi i shpërndarjes së fitimit dhe kthimi i pagesave të paautorizuara, transparenca mbi aksionet e veta, kontrolli mbi mbështetjen financiare për blerjen e tyre, si dhe vendosja e procedurave për pavlefshmërinë e bashkimeve dhe garantimi i sigurisë në transformimet strukture të shoqërive me ofertë publike.

Së dyti, objektivat janë të matshëm, pasi zbatimi i tyre mund të vlerësohet përmes treguesve të tillë si: numri i deklaratave të vetëdeklarimit të dorëzuara në Qendrën Kombëtare të Biznesit; numri i subjekteve që raportojnë zotërimin e aksioneve të veta dhe krijimin e rezervës përkatëse; rastet e aplikimit të dispozitave për pavlefshmërinë e bashkimeve; si dhe raportet e mbledhura mbi shpërndarjet e fitimit dhe kthimin e tyre.

Së treti, objektivat janë të arritshëm, pasi bazohen në kapacitetet ekzistuese të institucioneve të përfshira, si Qendra Kombëtare e Biznesit, shoqëritë tregtare dhe autoritetet mbikëqyrëse, pa imponuar nevojë për struktura të reja ose mekanizma të jashtëzakonshëm.

Së katërti, objektivat janë realë, pasi janë të mbështetur në përvojën ligjore të vendeve të BE-së dhe pasqyrojnë standarde të qarta të qeverisjes së shoqërive, duke respektuar proporcionalitetin midis kërkesave ligjore dhe kapaciteteve administrative.

Së fundi, objektivat janë në kohë, pasi ndërhyrjet e propozuara janë të planifikuara të hyjnë në fuqi brenda vitit kalendarik dhe zbatimi i tyre mund të fillojë menjëherë pas miratimit të akteve nënligjore dhe trajnimit të aktorëve përkatës, duke mundësuar vlerësim të progresit brenda një afati të arsyeshëm (12 muaj). Kjo e bën reformën të menaxhueshme dhe të verifikueshme në kohë reale nga ana e institucioneve përgjegjëse. Këto objektiva janë të realizueshme në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë, duke marrë parasysh mbështetje të vazhdueshme nga institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

1. *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
2. *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
3. *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Opsioni 0 (status quo)- nënkupton vijimin me kuadrin ligjor aktual. Nëse vlerësohet të zgjidhet ky opsion, do të vijohet me sistemet aktuale pa kërkuar veprime legjislative shtesë. Po ky opsion nuk është i mundur dhe as i përshtatshëm për t'u zbatuar për disa arsye. Së pari, anëtarësimi në BE kërkon përafrim të plotë me *acquis-in*, siç përcaktohet nga kriterit të Kopenhagenit vendosur nga Këshilli i Europës në vitin 1993, për "aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit" që burojnë nga të qenit vend anëtar. Shqipëria është e detyruar të përafrojë plotësisht legjislacionin e saj me *acquis-in* e BE-së dhe të zhvillojë kapacitete institucionale për ta zbatuar atë, siç përcaktohet gjithashtu nga Neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) dhe procesi i negociatave të anëtarësimit.. Së dyti, vetë Manuali për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator (RIA) i Këshillit të Ministrave të vitit 2016 nuk e lejon zgjedhjen e status quo-së si opsion kur harmonizimi është i detyrueshëm. Mbajtja e kuadrit aktual do të çonte në mos përputhshmëri të vazhdueshme me direktivat kryesore të BE-së, si Direktiva e Kodifikuar 2017/1132, duke lënë pa adresuar boshllëqet në ligjin 9901/2008. Kjo do të pengonte harmonizimin ligjor dhe infrastrukturor, duke e bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve për transpozim dhe, rrjedhimisht, duke rezultuar në mosanëtarësimin në BE dhe moszbatimin e politikave kombëtare për integrim, si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) dhe Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE). Pa veprim, kapaciteti institucional i Shqipërisë do të mbetet i pamjaftueshëm për të menaxhuar kompleksitetin e Direktivës së Kodifikuar për shoqëritë tregtare..

Opsioni 1 (Ndryshime në ligjin ekzistues) i preferuar -nënkupton kryerjen e ndryshimeve duke amenduar dhe shtuar ligjin aktual 9901/2008. Ky opsion fokusohet në një qasje konservatore për harmonizimin e ligjit 9901/2008 tregtare në Shqipëri me direktivat e BE-së duke qenë se edhe sipas progres raportit të Komisionit Evropian, Shqipëria ka një përgatitje mesatare dhe përafrim mesatar, çka nënkupton se duhen bërë përpjekje për të bërë hapin tjetër mbi një bazë ekzistuese dhe të pranuar. Ai përfshin adresimin

e boshllëqeve të identifikuara në Përkufizimit të Problemit dhe Objektivat e Politikës, duke ndërtuar njëkohësisht kapacitetin institucional të nevojshëm për të zbatuar këto reforma. Veprimet kyçe përfshijnë ndryshime të dispozitave ekzistuese shoqëruar me përpjekje për ndërtimin e kapaciteteve në institucione si Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI). Një mekanizëm i fortë monitorimi dhe vlerësimi do të ndjekë progresin. Ky opsion mundëson një transpozim të menaxhueshëm. Opsioni i transpozimit të plotë duke përshtatur ligjin ekzistues me direktivën e BE-së, pa ndryshuar strukturën e përgjithshme të ligjit, përfshin identifikimin e boshllëqeve ligjore dhe kryerjen e ndryshimeve ose shtesave vetëm për të adresuar këto boshllëqe. Kjo qasje siguron që kuadri ligjor ekzistues, që tashmë ka harmonizuar disa aspekte me legjislacionin e BE-së, të mbetet në fuqi, por të kompletohet me përditësimet e nevojshme në fushat ku nuk janë plotësisht të përshtatura me kërkesat e BE-së. Analiza ka nxjerrë në pah ndryshimet për të arritur përputhshmërinë e plotë si më poshtë:

Së pari, ligji aktual nuk parashikon mundësinë që degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive tregtare të regjistrohen në distancë përmes mjeteve elektronike, në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe kërkesat e Direktivës (BE) 2019/1151 për përdorimin e mjeteve dixhitale. Po ashtu, ai nuk përmban dispozita për çregjistrimin automatik të degëve në rastin e mbylljes së tyre ose të shoqërisë mëmë, duke sjellë pasiguri ligjore dhe mbingarkesë për regjistrin tregtar.

Së dyti, në fushën e transparencës institucionale dhe ndalimeve për administratorët, ligji nuk përmban ndalesa të shprehura për emërimin e personave që janë dënuar në shtete të tjera për vepra penale që përbëjnë pengesë sipas ligjit shqiptar, apo ndaj të cilëve është vendosur ndalim për ushtrimin e funksioneve për shkak të vendimeve gjyqësore ose masave administrative. Mungon gjithashtu çdo parashikim për vetëdeklarimin e pastërtisë ligjore nga administratorët e rinj dhe për ngritjen e një regjistri publik të personave të ndaluar, çka krijon risk të konsiderueshëm për integritetin e drejtimit të shoqërive.

Së treti, ligji nuk përmban një mekanizëm të saktë për përdorimin e fitimit dhe kthimin e pagesave të paautorizuara, duke lejuar që të shpërndahen fonde edhe në kushte kur pasuria neto është më e ulët se kapitali i kërkuar dhe rezervat e detyrueshme. Mungesa e një baze të qartë për kthimin e fitimeve të shpërndara në mënyrë të paligjshme dhe për përcaktimin e përgjegjësisë së aksionarëve dhe administratorëve në rastet përkatëse krijon një dëm të dyfishtë – si për kreditorët ashtu edhe për vetë shoqërinë.

Së katërti, ligji në fuqi ka mangësi në rregullimin e blerjes dhe zotërimit të aksioneve të veta, si dhe në rastin kur ato pranohen si garanci nga një palë e tretë për llogari të shoqërisë. Nuk kërkohet krijimi i një rezerve të veçantë për aksionet e zotëruara, nuk ka dispozita të detyrueshme për raportimin vjetor të tyre dhe nuk janë të përcaktuara kufizimet që duhet të aplikohen mbi të drejtat që rrjedhin nga këto aksione (si pezullimi i votës ose i pjesëmarrjes në fitim). Gjithashtu, ligji nuk përcakton qartë se dhënia e ndihmës financiare për blerjen e aksioneve të veta nga palë të treta, përveç rasteve të institucioneve financiare, përbën shkelje të barazisë ndërmjet aksionarëve dhe burim të mundshëm abuzimi të strukturës së kapitalit.

Së pesti, mungon një dispozitë që rregullon pavlefshmërinë e bashkimeve, duke mos ofruar asnjë rrugë ligjore për të sfiduar juridikisht një bashkim të kryer në mënyrë të paligjshme (për shembull, pa kontroll ligjshmërie apo me shkelje të formës). Kjo lë hapësirë për pasiguri të thellë kontraktuale dhe dëm për interesat e investitorëve, kreditorëve dhe vetë pjesëmarrësve në bashkim.

Së gjashti, ligji nuk parashikon asnjë garanci të veçantë për rastet kur një shoqëri aksionare me ofertë private transformohet në shoqëri me ofertë publike dhe anasjelltas. Ky lloj transformimi, ndonëse i rëndësishëm për zhvillimin e tregut të kapitalit dhe qasjen në financim publik, sjell pasoja të ndjeshme për investitorët ekzistues dhe potencialë, për punëmarrësit dhe për strukturën e kontrollit në shoqëri. Mungesa e dispozitave që garantojnë transparencën, raportimin nga administratorët, përfshirjen e ekspertëve të pavarur dhe të drejtën e kundërshtimit nga kreditorët dhe mbajtësit e instrumenteve financiare krijon rrezik të lartë për cenimin e interesave të palëve të treta dhe për dështimin e përputhshmërisë me standardet e BE-së për transformimet strukturore.

Ky opsion është më ekonomik dhe më efikas në kohë krahasuar me një rishkrimin e plotë të kodifikuar legjislationit ekzistues. Ai minimizon nevojën për ndryshime të mëdha në strukturën ligjore, duke reduktuar kostot që lidhen me hartimin e një legjislationi të ri ose krijimin e një direktive të re të kodifikuar. Duke u përqendruar vetëm në boshllëqet, Shqipëria mund të arrijë përputhshmëri të plotë me standardet e BE-së në një mënyrë më të targetuar, duke mundësuar zbatim më të shpejtë. Një përfitim i këtij opsioni është që struktura e ligjit ekzistues mbetet e pandryshuar. Kjo krijon mundësinë e vazhdimësisë për bizneset dhe profesionistët ligjorë që janë tashmë të njohur me këtë ligj. Po ashtu, sigurohet vazhdimësi dhe shmanget kompleksiteti që mund të lindë nga krijimi i një strukture të re ligjore. Ky opsion ofron fleksibilitet dhe mundësi për përshtatje më graduale ndaj ndryshimeve të ardhshme të ligjit të BE-së.

Opsioni 2 (Miratimi i një ligji të ri) – Miratimi i një ligji të ri të shoqërive tregtare ose Kodifikimi i tij si në nivel BE-je në Republikën e Shqipërisë është gjithashtu i konsiderueshëm për t’u zbatuar, por kërkon përpjekje masive në një mjedis ende shumë dinamik për të pasur një ligj tregtar të kodifikuar. Ky opsion mbështet një qasje më agresive, duke synuar transpozimin e shpejtë të plotë të të gjitha ligjeve tregtare, pra jo thjesht dhe vetëm ligjit 9901/2008 ligjit 9901/2008 në një ligj të ri të kodifikuar shoqëruar rrjedhimisht nga një reformë të plotë të kuadrit institucional. Transpozimi i ligjeve tregtare (përfshirë bashkimet, shndërrimet dhe ndarjet ndërkufitare si dhe legjislationin për regjistrimin e biznesit) në një direktivë të vetme të kodifikuar, të ngjashme me Direktivën 2017/1132 të BE-së, do të sigurojë një kuadër ligjor që do të imitonte atë të BE-së.

Megjithatë, transpozimi i shumë ligjeve në një direktivë të vetme kodifikuar i bazuar vetëm në Direktivën 2017/1132, nuk mund të jetë një Kod Tregtar i mirëfilltë, pasi edhe vetë Direktiva fokusohet vetëm në aspektet e ligjit 9901/2008 tregtare dhe nuk mbulon të gjitha fushat e ligjit tregtar, të tilla si aftësia paguese, falimentimi në përgjithësi, kontratat tregtare apo konkurrenca të cilat negociohen në kuadër të kapitujve të tjerë të Acquis. Për të krijuar një Kod Tregtar të vërtetë dhe gjithëpërfshirës, do të kërkohej jo vetëm transpozimi i Direktivës 2017/1132, por edhe i direktivave të tjera të lidhura me aftësinë paguese (p.sh., Direktiva (EU) 2019/1023 për procedurat e falimentimit, e cila negociohet në Kapitullin 20 “Ndërmarrjet dhe politikat industriale”. apo çështje të tjera që negociohen tek Kapitulli 9 për shërbimet financiare), si dhe direktiva të tjera për raportimin financiar dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Kjo do të kërkonte një përpjekje shumë më të gjerë dhe komplekse, duke tejkaluar objektivin e thjeshtë të harmonizimit me Direktivën 2017/1132.

Nga ana institucionale ky opsion do të ngarkonte rëndë institucionet ekzistuese të Shqipërisë, si Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), Ministrinë përgjegjëse për ekonominë dhe aktorët e tjerë të prekur. Këto institucione do të kërkonin përpjekje të konsiderueshme për të trajtuar kompleksitetin e ligjit të ri. Kjo mund të jetë një sfidë, veçanërisht duke pasur ndërthurjen e gjerë institucionale dhe nevojën për investime të mëtejshme në infrastrukturën digjitale.

Implementimi i një direktive të kodifikuar mund të sjellë kundërshtim nga bizneset, veçanërisht ato të vogla dhe të mesme (SMEs). Shumë SMEs mund të hasin vështirësi në përputhjen me kërkesat më të rrepta të ligjit, të tilla si ato të lidhura me qeverisjen korporative, operacionet ndërkufitare dhe mbrojtjen e të drejtave të aksionarëve.

Sistemi aktual ligjor i Shqipërisë mund të hasë sfida për të akomoduar transpozimin e plotë të rregulloreve të BE-së në një direktivë të vetme kodifikuar. Do të kërkohej ndryshime të rëndësishme ose shfuqizime në ligjet ekzistuese, përfshirë Ligjin nr. 9901/2008 dhe Ligjin nr. 110/2012 (për Bashkimet Ndërkufitare), për të siguruar përputhshmërinë me modelin e BE-së. Kjo mund të kërkojë kohë dhe burime të konsiderueshme për të integruar dhe pajtuar ligjet ekzistuese me direktivën e re si dhe ti japë vendit një ligj të gjatë prej qindra faqesh dhe të rëndë për tu lexuar dhe zbatuar, në raport me një sistem ligjor shqiptar i cili bazohet në ligje më të shkurtra dhe të kuptueshme..

Opsioni 3 (Jo rregullator)

Një qasje jo rregullatore do të nënkuptonte lejimin e bizneseve dhe aktorëve të tjerë relevantë të funksionojnë pa një kuadër të detajuar rregullator ose me ndërhyrje minimale nga shteti. Në këtë opsion, bizneset do të kishin lirinë për të vetë-rregulluar dhe për t'u pajtuar vullnetarisht me standardet bazë të BE-së, pa asnjë detyrim ligjor për të zbatuar rregulla të detajuara që lidhen me formimin e shoqërive, të drejtat e aksionarëve, operacionet ndërkufitare ose qeverisjen korporative.

Në kontekstin e harmonizimit të direktivës 2017/1132, ky opsion jo rregullator do të sugjeronte që shoqëritë të veprojnë në mënyrë të pavarur pa detyrime ligjore të plota ose kufizime të qarta. Për shembull, shoqëritë nuk do të ishin të detyruara të miratonin mjete digjitale të standardizuara për operacione si formimi i shoqërive ose bashkimet, as nuk do të kishte kërkesa të detyrueshme për transparencën e aksionarëve, ose harmonizimin me kornizën e BE-së për operacionet ndërkufitare. Megjithatë, ky opsion nuk mund të konsiderohet si një mundësi e vlefshme për Shqipërinë për disa arsye:

1. Si një shtet kandidat për në BE, dhe në zbatim të nenit 70 të MSA-së, Shqipëria është e detyruar ligjërisht të harmonizojë legjislacionin e saj kombëtar me rregulloret e BE-së si pjesë e procesit të integritimit në BE. Bashkimi Evropian ka vendosur një kuadër rregullator të detyrueshëm, në të cilin shtetet anëtare duhet të funksionojnë, veçanërisht në fushat e ligjit 9901/2008, operacioneve ndërkufitare dhe qeverisjes korporative. Papajtueshmëria me këto rregullore do të minonte procesin e integritimit të Shqipërisë dhe do ta shtynte më tej anëtarësimin e saj në BE.
2. Mungesa e një kuadri të qartë rregullator do të krijonte pasiguri të konsiderueshme për investitorët, bizneset dhe aktorët relevantë. Pa një grup të rregullave të detajuara në vend, Shqipëria nuk do të mund të garantojë mbrojtjen e investimeve, funksionimin e duhur të tregut të brendshëm dhe konkurrencën e drejtë. Bizneset nuk do të kishin sigurinë se investimet e tyre janë të mbrojtura, veçanërisht në fusha si bashkimet, të drejtat e aksionarëve dhe transparenca e shoqërive. Ky skenar do të çonte në tërheqjen e pakët të investimeve të huaja, të cilat janë thelbësore për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.
3. Bashkimi Evropian kërkon masa specifike për të mbrojtur interesat e palëve të interesuara, për të siguruar transparencë dhe për të promovuar praktika të drejta biznesi. Një qasje jo rregullatore do të injoronte këto kërkesa dhe do të linte Shqipërinë jashtë përputhshmërisë me BE-në. Një situatë e tillë do të pengonte Shqipërinë të merrte pjesë plotësisht në tregun e brendshëm të BE-së dhe mund të rezultonte në sanksione ose barriera tregtare me shtetet anëtare të BE-së.
4. Nëse do të lihen shoqëritë dhe institucionet të vetë-rregullohen, do të ketë një rrezik të madh për praktika të pasqaruara, ku disa biznese mund të përmbushin praktikën më të mira ndërkombëtare ndërsa të tjera jo. Ky skenar do të çonte në një treg të fragmentuar ku shoqëritë që respektojnë standardet ndërkombëtare do të ishin në një pozitë disavantazhi krahasuar me ato që shmangin detyrimet rregullatore. Kjo gjithashtu do të dobësonte aftësinë e shtetit për të monitoruar dhe zbatuar përputhshmërinë ligjore në mënyrë efektive, duke çuar në mundësi të abuzimit dhe praktika të padrejta.
5. Qëllimi i strategjisë së integritimit të Shqipërisë në BE është harmonizimi i standardeve të saj me ato evropiane për të fituar akses në përfitimet e anëtarësimin, si rritja ekonomike, stabiliteti politik dhe integriteti në treg. Një qasje jo rregullatore do të shkelte këtë strategji dhe do të funksiononte kundër objektivave për miratimin e ligjeve dhe kuadrave përputhëse me BE-në.

Për këto arsye, opsioni jo rregullator nuk mund të konsiderohet si një mundësi e vlefshme për harmonizimin e ligjit 9901/2008 të Shqipërisë me rregulloret e BE-së. Vendi duhet të zbatojë masa rregullatore të plota për të përmbushur angazhimet e tij për integritetin në BE, për të promovuar besueshmërinë e investitorëve, për të siguruar kushte të drejta konkurruese dhe për të mbrojtur të drejtat e palëve të interesuara në një mënyrë që është në përputhje me standardet evropiane.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

g) Identifikoni grupet e prekura.

h) Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.

i) Për ndikimet e drejtpërdrejta:

- a. Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- b. Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
- c. Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
- d. Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*

j) Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:

- a. Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- b. Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*

k) Diskutoni kufizimin e analizës:

- a. Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
- b. Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*

l) Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:

- a. Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
- b. Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
- c. Paraqisni përllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Identifikimi i grupeve të prekura:

1. Bizneset, veçanërisht ato të mëdha dhe të huaja
2. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SMEs)
3. Institucionet shtetërore
4. Shoqëria civile dhe sektori i mbikëqyrjes
5. Investitorët e huaj dhe ata vendas
6. Profesionalët ligjorë
7. Aksionarët/ortakët (përfshirë aksionarët e pakicës)
8. Noterët

Ndryshimet ligjore do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe tërthorazi në këto grupe. Ndërmarrjet dhe sektorët që operojnë në tregje ndërkombëtare, si dhe institucionet që mbikëqyrin këto aktivitete, do të përballen me sfida dhe mundësi për shkak të kërkesave të reja për transparencë, qeverisje korporative dhe operacione ndërkufitare.

Identifikimi i llojeve të ndikimeve për secilin grup të prekur:

Ndryshimet e propozuara në Ligjin nr. 9901/2008 do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë dhe të shumëfishtë mbi aktorët kryesorë të përfshirë në jetën ekonomike dhe institucionale të vendit. Këto ndërhyrje janë konceptuar për të përmirësuar sigurinë juridike, për të rritur besimin në tregun e brendshëm dhe për të përmbushur kërkesat për përafrim me *acquis-in* e BE-së në kuadër të Kapitullit 6 të negociatave.

Për shoqëritë tregtare, ndryshimet do të sjellin një kuadër më të qartë dhe më të strukturuar në lidhje me shpërndarjen e fitimeve, zotërimin e aksioneve të veta, pranimin e tyre si garanci dhe ndalimin e mbështetjes financiare për blerjen e tyre nga palë të treta. Këto masa do të kërkojnë përshtatje të procedurave të brendshme dhe standardeve të qeverisjes korporative, si dhe raportim më të detajuar në pasqyrat vjetore. Shoqëritë që kalojnë nga forma e ofertës private në ofertë publike do të jenë të detyruara të respektojnë një sërë garancish shtesë që lidhen me transparencën, vlerësimin e aktiveve, dhe mbrojtjen e mbajtësve të instrumenteve financiare, gjë që mund të përkthehet në rritje të kostove administrative, por që njëkohësisht përforcon reputacionin dhe besueshmërinë e tyre në treg.

Për aksionarët, ndryshimet sjellin përmirësim të ndjeshëm në nivelin e mbrojtjes juridike, sidomos në rastet e shpërndarjeve të paautorizuara, blerjeve të aksioneve nga shoqëria apo mospërputhjes me kërkesat për ruajtjen e kapitalit. Dispozitat për kthimin e fondeve të marra në kundërshtim me ligjin, përfshirë përgjegjësinë solidarë të aksionarëve dhe të anëtarëve të organeve drejtuese, krijojnë një sistem më të drejtë dhe të ekuilibruar në raport me interesat e kreditorëve dhe mbrojtjen e kapitalit të shoqërisë. Gjithashtu, mundësia për të ndjekur procedura ligjore në rast të pavlefshmërisë së bashkimeve rrit sigurinë procedurale dhe u jep aksionarëve mjete efektive për të kundërshtuar shkeljet e ligjit.

Institucionet shtetërore, kryesisht Qendra Kombëtare e Biznesit, do të kenë rol të zgjeruar në zbatimin e këtyre dispozitave, përfshirë ngritjen dhe administrimin e një regjistri të personave të ndaluar për ushtrimin e funksioneve drejtuese dhe mbikëqyrëse. QKB do të duhet të përpunojë dhe verifikojë deklaratat e vetëdeklarimit të administratorëve dhe të garantojë zbatimin e afateve të ruajtjes dhe fshirjes së të dhënave personale në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave. Kjo do të kërkojë rishikim të infrastrukturës digjitale, trajnime të stafit dhe bashkërendim më të ngushtë me ministrinë përgjegjëse për ekonominë, e cila do të miratojë rregulloren për funksionimin e regjistrit. Gjykatat do të pajisen me kompetenca të reja për të shqyrtuar kërkesat për pavlefshmërinë e bashkimeve, duke imponuar trajnime të posaçme për gjyqtarët në fushën e së drejtës korporative dhe transformimeve strukturore.

Nga këto ndërhyrje priten gjithashtu ndikime pozitive në nivel ekonomik dhe institucional afatmesëm dhe afatgjatë. Forcimi i disiplinës korporative, rritja e transparencës financiare dhe siguri i një mjedisi të rregullt për transformimet e shoqërive, do të kontribuojnë në përmirësimin e klimës së investimeve dhe tërheqjen e kapitalit të huaj, veçanërisht për sektorët që synojnë të aksesojnë tregjet publike të kapitalit. Në aspektin institucional, reforma forcon kapacitetin e shtetit për të mbikëqyruar në mënyrë të strukturuar tregun e korporatave dhe për të garantuar përputhshmëri të qëndrueshme me standardet e BE-së..

Ndikimi ekonomik

Ndikimi ekonomik i harmonizimit të ligjit 9901/20089901/2008 me acquis-in e BE-së është i rëndësishëm, veçanërisht në krijimin e një mjedisi biznesi më të parashikueshëm dhe transparent. Një kuadër ligjor që është plotësisht në përputhje me rregulloret e BE-së do të ofrojë rregulla të qarta dhe të standardizuara për operacionet e biznesit, duke përmirësuar besimin e investitorëve, duke lehtësuar qasjen në financim dhe duke stimuluar rritjen ekonomike.

Rritja e Investimeve të Huaja të Drejtpërdrejta (FDI): Harmonizimi me Direktivën do të rrisë tërheqjen e Shqipërisë si destinacion investimi. Krijimi i një mjedisi ligjor më të parashikueshëm dhe transparent do të tërheqë më shumë FDI, veçanërisht në sektorë si teknologjia, prodhimi dhe shërbimet, ku investitorët ndërkombëtarë kërkojnë qartësi për të drejtat e aksionarëve, qeverisjen korporative dhe mundësinë për të realizuar transaksione ndërkufitare.

Përmirësimi i qasjes në tregjet e BE-së: Integrimi i Shqipërisë në tregun e brendshëm të BE-së do të forcohet përmes harmonizimit të ligjit 9901/2008 me rregulloret e BE-së, duke lejuar që bizneset shqiptare të operojnë në disa juridiksione me më pak pengesa ligjore. Kjo do të përmirësojë konkurrencën dhe do të lehtësojë qasjen në tregje më të mëdha.

Përmirësimi i klimës së biznesit: Zbatimi i një kuadri ligjor të harmonizuar do të përmirësojë lehtësinë e zhvillimit të biznesit në Shqipëri duke thjeshtuar procedurat korporative, si regjistrimi, raportimi dhe qeverisja. Thjeshtësimi i këtyre proceseve do të inkurajojë sipërmarrësit dhe inovacionin, duke kontribuar në diversifikimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës.

Kostot e mundshme ekonomike: Kostot e menjëhershme që lidhen me harmonizimin përfshijnë kostot e rishikimit të ligjit, përditësimin e proceseve institucionale, trajnimin e profesionistëve dhe implementimin e sistemeve të reja për monitorimin e përputhshmërisë. Mund të ketë disa përshtatje afatshkurtra pasi bizneset me rregullat dhe kërkesat e reja të përputhshmërisë, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME). Megjithatë, këto janë të përkohshme dhe përfitimet afatgjata do të tejkalojnë kostot e përshtatjes.

Ndikimi social

Ndikimi social i harmonizimit të ligjit 9901/2008 me acquis-in e BE-së është gjithashtu i rëndësishëm. Harmonizimi me rregulloret e BE-së jo vetëm që përmirëson mjedisin ligjor për bizneset, por do të hapë rrugë që në të ardhmen për shembull transpozimit të Direktivës 2022/2381, e cila kërkon balancën gjinore mes drejtorëve të shoqërive të listuara, për promovimin e barazisë gjinore në sektorin korporativ të Shqipërisë.

Po ashtu, forcimi i të drejtave të aksionarëve, veçanërisht për aksionarët e pakicës, është në përputhje me objektivat më të gjerë të BE-së për të promovuar transparencën dhe përgjegjësinë më të madhe në praktikën e biznesit.

Kalimi në një kuadër ligjor më të harmonizuar me BE-në mund të kërkojë nga disa biznese që të ristrukturohen. Megjithatë, këto kosto priten të tejkalohen nga përfitimet afatgjata. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Shqipëri mund të përballen me sfida në përshtatjen me kuadrin ligjor të ri. Këto biznese mund të kenë nevojë për mbështetje dhe trajnime shtesë për të siguruar përputhshmërinë me rregullat e reja. Kjo mund të zbatet përmes ndihmës teknike dhe programeve trajnime nga qeveria dhe partnerët ndërkombëtarë.

Ndikimi institucional

Procesi i harmonizimit të ligjit 9901/2008 të Shqipërisë me rregulloret e BE-së do të çojë në një forcim të konsiderueshëm të institucioneve ligjore dhe rregullatore të vendit. QKB, MEKI, Autoriteti i Konkurrencës dhe potencialisht AMF për çështje që do ndërlidhjen pas transpozimit të Direktivës 2017/1132, do të kërkojnë përpjekje ndihmëse për ndërtimin e kapaciteteve, gjë që do të përmirësojë aftësinë e tyre për të monitoruar përputhshmërinë me rregulloret e BE-së, për të zbatuar standardet e qeverisjes korporative dhe për të menaxhuar operacionet ndërkufitare. Me përputhshmëri të plotë me ligjin 9901/2008 të BE-së, kuadri ligjor i Shqipërisë do të bëhet më të parashikueshëm, transparent dhe në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Kjo do të sigurojë më shumë siguri ligjore për bizneset dhe sipërmarrësit, duke krijuar një mjedis biznesi më të qëndrueshëm dhe efikas. Ndërsa reforma institucionale zhvillohet, aftësia e Shqipërisë

për të koordinuar përpjekjet ndërmjet institucioneve të ndryshme rregullatore do të përmirësohet. Kjo do të çojë në një zbatim më efikas të rregullave të ligjit 9901/2008, duke reduktuar pasiguritë burokratike dhe duke thjeshtësuar proceset rregullatore. Duke qenë se shumë institucione janë të përfshira në zbatimin dhe mbikëqyrjen e reformave të ligjit 9901/2008, siguria e koordinimit të qartë dhe ndarjes së përgjegjësi është e rëndësishme. Nëse institucionet nuk janë plotësisht të pajisura për të menaxhuar ngarkesën e shtuar, mund të lindin paqartësi dhe vonesa. Megjithatë, këto sfida do të zvogëlohen ndërsa Shqipëria ndihmohet të zhvillojë kapacitetin dhe të rafinojë kuadrin e saj institucional.

a. Përshkrimi cilësor i ndikimeve të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura:

Për bizneset, përditësimi i rregullave të qeverisjes korporatave do të krijojë mundësi për një mjedis më të qëndrueshëm dhe më të parashikueshëm, duke rritur besueshmërinë dhe tërheqjen për investitorët, sidomos ata ndërkombëtarë. Përshtatja e kërkesave ligjore për publikimin e informacionit, përjashtimin e administratorëve, angazhimin afatgjatë të aksionarëve dhe mbrojtjen e interesave të aksionarëve të vegjël do të kontribuoni në një mjedis më të sigurt dhe më transparent për bizneset, duke rritur ndihmën për zhvillimin ekonomik dhe rritjen e konkurrencës.

b. Analiza nga ana sasiore e ndikimeve të drejtpërdrejta:

Përfitimet ekonomike që lidhen me rritjen e investimeve të huaja mund të jenë të konsiderueshme. Shqipëria mund të tërheqë investime të huaja të drejtpërdrejta, të cilat mund të shkurtojnë periudhën e rikuperimit për disa vite dhe të kontribuojnë në rritjen e mundësive të punësimit dhe zhvillimin e sektorëve të ndryshëm ekonomikë. Sipas statistikave të INSTAT për vitin 2023, janë regjistruar rreth 150,000 shoqëri, me një shumicë të madhe që përfaqësojnë SMEs, të cilat do të kenë mundësi për të rritur aktivitetet e tyre ndërkufitare.

c. Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur:

Përfitimet e mundshme nga investimet e huaja të drejtpërdrejta dhe rritja e mundësive për operacione ndërkufitare mund të arrijnë disa milionë euro gjatë periudhës së parë pas implementimit të reformave. Ky investim do të kontribuojë në zhvillimin e tregjeve të brendshme dhe në mundësitë e përmirësimit të konkurrueshmërisë për shoqëritë shqiptare. Përfitimet monetare mund të përlllogariten bazuar në rritjen e investimeve të huaja dhe përmirësimin e aksesit në financa për bizneset lokale. Ndikimet financiare mund të përfshijnë rritjen e kapitalit të huaj, që mund të jetë nga 2% deri në 5% të PBB-së për periudhën e ardhshme.

Nga ana sasiore, përfitimet ekonomike që lidhen me zhvillimin e sektorëve të ndryshëm, si pasojë e rritjes së investimeve të huaja dhe përmirësimit të tregjeve të brendshme, mund të arrijnë një vlerë të përafërt prej 50 milionë euro në total. Kjo shumë jo vetëm që mbulon kostot e implementimit të reformës, e cila është relativisht e ulët dhe kryesisht lidhet me trajnimin e sektorit publik dhe privat, por gjithashtu krijon një bazë të fortë për rritje të mëtejshme ekonomike.

Sipas analizave të Bankës Botërore të muajit Nëntor 2024, kthimi nga investimet në Shqipëri është 10%, që do të thotë se për çdo 1 euro të investuar, përfitimi është 10 euro.

Nëse investimet në Shqipëri rriten me 2% të PBB-së, duke marrë për bazë PBB-në e vitit 2023, që ishte rreth 23.6 miliardë euro (Burimi: INSTAT), atëherë përfitimi i pritur arrin nga 47.2 milionë euro deri në 50 milionë euro².

d. Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka):

SMEs do të preken drejtpërdrejt nga nevoja për të përfituar dokumentet dhe procedurat për t'u përputhur me kërkesat e reja ligjore. Ky proces mund të kërkojë burime të konsiderueshme për trajnime dhe mbështetje ligjore, veçanërisht për ato që janë të angazhuara në tregje ndërkombëtare. Përshtatja mund të jetë një sfidë për ato që nuk kanë kapacitetin financiar dhe administrativ për të zbatuar këto ndryshime.

Në këtë mënyrë, ky opsion i reformës ligjore do të sjellë përfitime të ndjeshme për të gjitha grupet e prekura, duke përmirësuar mundësitë për investime dhe biznes, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe duke siguruar një mjedis ligjor të stabilizuar dhe të qëndrueshëm.

Ndikimet jo të drejtpërdrejta do të shtrihen përtej mundësive të drejtpërdrejta për rritjen e besimit të investitorëve dhe zhvillimin e tregjeve. Me implementimin e këtyre ndryshimeve, Shqipëria mund të tërheqë investitorë të rinj, që do të kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë dhe mundësitë për bashkëpunim ndërkombëtar.

Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:

a. Përshkrimi nga ana cilësore i ndikimeve jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura:

Zbatimi i ndryshimeve të propozuara në Ligjin nr. 9901/2008 pritet të ketë ndikime jo vetëm në planin teknik dhe formal të qeverisjes korporative, por edhe në mënyrë të tërthortë në perceptimin institucional të Shqipërisë si një vend me mjedis ligjor të sigurt dhe të harmonizuar me standardet evropiane. Kjo pritet të reflektohet në përmirësimin e imazhit të vendit si destinacion investimi, duke rritur besimin e investitorëve të huaj dhe të sektorëve financiarë ndërkombëtarë në stabilitetin ligjor dhe parashikueshmërinë e transaksioneve korporative në Shqipëri. Për më tepër, përmirësimi i infrastrukturës ligjore për funksionimin e tregut të kapitalit, transparencën e raportimeve dhe mbrojtjen e aksionarëve do të ndikojë në mënyrë të tërthortë në përmirësimin e qasjes në financim për shoqëritë aksionare, sidomos ato që synojnë transformimin drejt ofertës publike.

b. Analizoni ndikimin mbi konkurrencën:

Ndryshimet ligjore do të krijojnë një treg më të hapur dhe më konkurrues, duke lehtësuar operacionet ndërkufitare dhe duke rritur mundësitë për rritjen e konkurrencës në nivel ndërkombëtar. Implementimi i standardeve të BE-së për mbrojtjen e aksionarëve dhe transparencën do të mundësojë krijimin e një mjedisi më të besueshëm për investitorët dhe bizneset. Harmonizimi i legjislacionit të Shqipërisë do të rrisë konkurrencën në tregun lokal, duke mundësuar që bizneset shqiptare të konkurrojnë në kushte të barabarta me ato të vendeve të BE-së. Për më tepër, krijimi i një tregu të hapur dhe të parashikueshëm për investitorët do të ndihmojë në diversifikimin e ekonomisë dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve.

Diskutimi i kufizimit të analizës:

² (<https://www.instat.gov.al/media/14074/rishikimi-madhori-llogarive-komb%C3%ABtare-2024.pdf>;

a. Supozimet dhe risqet:

Analiza është bazuar në supozimin që institucionet shtetërore do të kenë mundësinë të ndërtojnë kapacitetet e nevojshme për të implementuar ndryshimet e ligjit. Risqet lidhen me mundësinë që disa nga këto reforma të mos implementohen në mënyrë të duhur për shkak të mungesës së burimeve ose mbështetjes teknike të nevojshme. Parashikimet bazohen në premisa të besueshme për rritjen e investimeve dhe mundësitë për tërheqjen e investorëve të huaj, bazuar në harmonizimin e ligjit shqiptar me normat e BE-së. Megjithatë, ka rrezik që ndarja e kapitalit dhe investimet e huaja të ndikohen nga sfida të papritura si mungesa e mbështetjes institucionale për të menaxhuar këtë kalim dhe mundësia e ndonjë vonese të theksuar në implementimin e teknologjisë së re digjitale.

b. Pengesat që mund të ndikojnë në realizimin e përfitimeve:

Përfitimet që lidhen me krijimin e një mjedisi më të thjeshtë për SME mund të përkthehen në rritjen e numrit të biznesve të regjistruara dhe operacioneve të reja, duke ndikuar pozitivisht në punësimin dhe rritjen e produktivitetit. Pengesat mund të përfshijnë vonesat në ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe implementimin e mjetëve digjitale, të cilat do të kërkojnë burime të konsiderueshme financiare. Gjithashtu, ka mundësi që SMEs të përballen me vështirësi për t'u përshtatur me këto ndryshime për shkak të kostos dhe nevojës për trajnime të mëtejshme.

Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:

a) Pasqyrë përmbledhëse e ndikimeve të opsioneve të analizuar

Ndikimet e parashikuara nga ndërhyrjet e propozuara në Ligjin nr. 9901/2008 pritet të jenë të shumanshme dhe të thella, me ndikim pozitiv në funksionimin e shoqërive tregtare dhe klimën e përgjithshme të të bërit biznes në Shqipëri. Ndryshimet do të çojnë në përmirësimin e mekanizmave të brendshëm të qeverisjes korporative, do të vendosin standarde të qarta mbi shpërndarjen e fitimit, mbrojtjen e kapitalit dhe transparencën në zotërimin dhe përdorimin e aksioneve të veta, si dhe do të përforcojnë kontrollin mbi përfaqësimin ligjor të shoqërive përmes ndalimeve për administratorët e papërshtatshëm. Këto masa synojnë të krijojnë një mjedis më të parashikueshëm dhe më të besueshëm për të gjithë pjesëmarrësit në treg, duke ndikuar pozitivisht në qasjen në financim, konkurrencën dhe tërheqjen e investimeve.

Përfshirja e dispozitave të reja mbi pavlefshmërinë e bashkimeve dhe garantimi i mbrojtjes në rastet e transformimeve ndërmjet ofertës private dhe publike i afron mekanizmat mbrojtës shqiptarë me parimet themelore të së drejtës së BE-së, duke përmirësuar sigurinë juridike dhe duke ndihmuar në zhvillimin e një tregu të kapitalit më transparent dhe funksional. Këto reforma mbështesin një integrim më të thelluar të Shqipërisë në tregun e përbashkët të BE-së dhe përforcojnë pozitën e saj si një ekonomi në përaftrim me rregullat evropiane.

b) Krahasimi i ndikimeve të opsioneve të analizuar

Në fazën e analizës janë marrë në shqyrtim tre opsione kryesore. Opsioni i parë – ndryshimi selektiv i Ligjit nr. 9901/2008 me qëllim harmonizimin e tij të plotë me kërkesat e Direktives (BE) 2017/1132 dhe ndryshimeve të mëvonshme rezulton të jetë opsioni më praktik, më i arritshëm dhe më i lehtë për t'u implementuar nga institucionet dhe bizneset shqiptare. Ky opsion përfiton nga njohja dhe zbatimi tashmë i konsoliduar i ligjit ekzistues dhe mundëson integrimin e dispozitave të reja pa krijuar ngarkesë disproporcionale ose pasiguri interpretative për praktikuesit dhe autoritetet zbatuese.

Opsioni i dytë miratimi i një ligji tërësisht të ri, të formuluar mbi modelin e drejtpërdrejtë të Direktives 2017/1132 ndonëse ofron një përputhshmëri tekstuale më të lartë, rezulton të jetë më pak efikas në praktikë.

Kjo për shkak të nevojës për riformatim të plotë të arkitekturës ligjore, rikodifikim, rishikim të sistemit të referencave dhe trajnim të gjerë të aktorëve të përfshirë. Një ligj krejtësisht i ri do të kërkonte kohë të gjatë për tu përvetësuar, do të krijonte vështirësi të konsiderueshme të zbatimit dhe nuk do të siguronte një kalim të qetë institucional në afat të shkurtër.

Opsioni i mosndërhyrjes ose ruajtjes së status quo-së (opsioni zero) është përjashtuar që në fillim të analizës, pasi do të linte boshllëqe të mëdha në kuadrin ligjor dhe do të minonte detyrimet e Shqipërisë në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe negociatave të anëtarësimit në BE.

c. Përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsjon:

Përfitimet monetare nga implementimi i këtyre ndryshimeve ligjore mund të përkthehen në rritje të investimeve të huaja të drejtpërdrejta, që mund të arrijnë disa milionë euro gjatë periudhës së parë pas implementimit të reformave. Ky investim do të kontribuoni në zhvillimin e sektorëve të shërbimeve, teknologjisë dhe prodhimit, duke sjellë rritje të mundshme të PBB-së dhe duke krijuar mundësi të reja për krijimin e vendeve të punës. Për më tepër, duke siguruar përputhshmëri të plotë me rregulloret e BE-së dhe duke përmirësuar konkurrencën, Shqipëria mund të rrisë pozicionin e saj si destinacion investimesh dhe të mundësojë operacione më të lehta dhe më të shpejta ndërkufitare.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

1. *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
2. *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i preferuar është Opsioni 1- Ndryshime në legjislacionin ekzistues.

Ky opsion është zgjedhur si më i përshtatshmi për arsyet se ai ofron një qasje graduale, të kontrollueshme dhe të zbatueshme për përafrimin me *acquis-in* e Bashkimit Evropian, duke ndërtuar mbi një kuadër ligjor tashmë të konsoliduar dhe të njohur nga institucionet publike, bizneset dhe komuniteti i praktikuesve të ligjit. Ndryshimet e propozuara janë të fokusuara në adresimin e boshllëqeve specifike që janë identifikuar gjatë analizës së legjislacionit ekzistues në krahasim me kërkesat e Direktivës (BE) 2017/1132, të ndryshuar nga Direktiva (BE) 2019/2121, si dhe me zhvillimet e fundit të standardeve të qeverisjes korporative në nivel evropian.

Opsioni i ndryshimit të ligjit ekzistues është më realist dhe institucionalisht më i përballueshëm, pasi lejon përfshirjen e dispozitave të reja (për shembull, rregullat mbi vetëdeklarimin dhe ndalimin e administratorëve të papërshtatshëm, përdorimin dhe kthimin e fitimit, kufizimet mbi aksionet e veta dhe garancitë në transformimet strukturore) pa cenuar koherencën sistematike të ligjit në fuqi dhe pa krijuar pasiguri apo mbingarkesë për subjektet zbatuese. Në vend që të rikonceptohet i gjithë ligji, kjo qasje përqendrohet në shtimin e dispozitave të qarta dhe të harmonizuara, që integrohen natyrshëm në strukturën ekzistuese të ligjit nr. 9901/2008.

Për më tepër, kjo metodë ruan kohezionin institucional dhe shmang kostot dhe rezistencën që mund të lindin nga zëvendësimi i një ligji të konsoliduar me një instrument të ri juridik. Ajo lejon ndërhyrjen pa rritur barrën administrative për shoqëritë tregtare dhe ofron kohë për përshtatje, përfshirë mbështetje teknike për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që mund të përballen me vështirësi në zbatimin e detyrimeve të reja.

Në aspektin financiar dhe operacional, ky opsion është më i përballueshëm për institucionet si Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), të cilat do të jenë të angazhuara në implementimin e dispozitave të reja për regjistrin e ndalimeve, verifikimin e deklaratave dhe përshtatjen e procedurave të regjistrimit dhe raportimit financiar. Këto institucione nuk kanë nevojë të krijojnë struktura të reja, por mund të përdorin infrastrukturën ekzistuese për të integruar zbatimin e ndryshimeve përmes rregulloreve nënligjore dhe përditësimit të sistemeve digjitale.

Nga këndvështrimi i harmonizimit ligjor, kjo qasje ofron gjithashtu fleksibilitet për të përfshirë në të ardhmen direktiva të tjera të BE-së që lidhen me qeverisjen e shoqërive, si ato mbi raportimin e qëndrueshmërisë apo reformat në të drejtën e falimentimit. Kjo do të mundësojë një përafrim të qëndrueshëm, dinamik dhe të kontrolluar të kuadrit kombëtar me evoluimin e standardeve evropiane, pa pasur nevojë për ndryshime rrënjësore çdo herë që acquis-i pëson rishikime.

Përmbledhtas, Opsioni 1 është opsioni më i përshtatshëm në kushtet aktuale të Shqipërisë, sepse ndërton mbi një kuadër të qëndrueshëm, është më i lehtë për t'u implementuar, ofron përfitime të menjëhershme në aspektin e sigurisë ligjore dhe përputhshmërisë me BE-në, dhe minimizon kostot e adaptimit në krahasim me alternativa më radikale dhe të ngarkuara si kodifikimi i plotë nga e para (Opsioni 2).

Kostot Buxhetore

Kostot buxhetore të implementimit të Opsionit 1 janë disa, por të menaxhueshme në kuadrin e strategjisë më të gjerë të integrimit të Shqipërisë në BE. Investimet e nevojshme do të drejtohen kryesisht në ndërtimin e kapaciteteve institucionale, duke përfshirë programe trajnimi për profesionistët, krijimin e infrastrukturës digjitale dhe për operacionet ndërkufitare. Gjithashtu, financimi do të jetë i nevojshëm për konsultime, këshilla nga ekspertë dhe kostot administrative të miratimit dhe zbatimit të ligjeve të reja.

Duke qenë se e kemi të pamundur të kryejmë një analizë sasiore të ndikimeve ekonomike të opsionit të preferuar, pasi kuantifikimi i kostove dhe përfitimeve nga ndryshimet e parashikuara në vlerë monetare rezulton i pjesshëm dhe i vështirë për t'u bërë, kemi vlerësuar si metodë më të përshtatshme për të analizuar opsionet metodën e analizës me shumë kriterë.

Si rezultat kemi identifikuar 5 kriterë me rëndësi për të vlerësuar:

- Përmirësimi, harmonizimi dhe qartësimi i kuadrit ligjor lidhur me shoqëritë tregtare mbi bazën e ligjeve ekzistuese - 4
- Përfshirja e bashkimit, ndarjes ndërkufitare, mbrojtjes aksionare etj në ligje tashmë të njohura – 3;
- Krijimi i mekanizmave për përafrim digjital; - 4
- Efikasiteti në nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe shfrytëzimi me efikasitet të kuadrit ligjor.-3
- Kosto më të njohura administrative; - 3

Këto kriterë janë vlerësuar me pikë për secilin opsion si vijon:

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2
Përmirësimi, harmonizimi dhe qartësimi i kuadrit ligjor lidhur me shoqëritë tregtare mbi bazën e ligjeve ekzistuese	4	0 (0)	3 (12)	0 (0)
Përfshirja e bashkimit, ndarjes ndërkufitare, mbrojtjes aksionare etj në ligje tashmë të njohura	3	0 (0)	3 (9)	2(6)
Krijimi i mekanizmave për përafrim digjital	4	0 (0)	4 (16)	0(0)

Efikasiteti në nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe shfrytëzimi me efikasitet i kuadrit ligjor.	3	2 (6)	3 (9)	2 (6)
Kosto më të njohura administrative;	3	0 (0)	2 (6)	0 (0)
Pikët		6	52	12

Nga analiza e kryer, bazuar në kriteret e përmendura si më lart, duke vlerësuar secilin opsion, rezultojnë se opsioni 1 ka numrin më të lartë të pikëve me 52 krahasuar me opsionet e tjera.

Çështje të zbatimit

1. *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
2. *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
3. *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Struktura përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur

Ministria përgjegjëse për ekonominë. Si institucioni kryesor që mbikëqyr politikën ekonomike dhe reformën rregullatore, ministria përgjegjëse për ekonominë do të luajë një rol kyç në sigurimin e miratimit dhe integritetit të ndryshimeve ligjore në kuadrin ligjor kombëtar. Ajo do të mbikëqyr harmonizimin me direktivat e BE-së dhe do të punojë me institucione të tjera për të zhvilluar strategjitë e implementimit.

Ministria përgjegjëse për financat nga ana tjetër do të jetë gjithashtu përgjegjëse për lidhjen me BE-në dhe monitorimin e përputhshmërisë me kërkesat fiskale dhe ligjore të BE-së, çka do të fusë në lojë edhe administratën tatimore.

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB): QKB do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të bizneseve dhe implementimin e mjeteve digjitale për të siguruar përputhshmërinë me rregullat e reja të qeverisjes korporative dhe standardet për operacionet ndërkufitare. Ajo do të punojë me ministrinë përgjegjëse për ekonominë dhe institucione të tjera, të tilla si AKSHI dhe AKCESK për të siguruar që procedurat e regjistrimit të bizneseve dhe rregulloret të jenë të thjeshtuara dhe në përputhje me kërkesat e BE-së. QKB do të luajë një rol kyç në digitalizimin e regjistrave dhe përdorimin e platformave digjitale për të lehtësuar regjistrimin dhe proceset e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare. Pasi specifikimet teknike të regjistrave të biznesit që do të lidhën midis tyre të rishikohen nga Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, mund të vazhdohet me hapat e nevojshëm që duhet të ndërmerren për të mundësuar lidhjen e regjistrimit të biznesit të Shqipërisë me BRIS.

Instituti i Statistikave (INSTAT): INSTAT do të mbledhë dhe analizojë të dhëna për të matur ndikimin e reformave. Ajo do të ndjekë tregues ekonomikë si rritja e biznesit, investimet e huaja të drejtpërdrejta dhe standardet e qeverisjes korporative. INSTAT do të ofrojë të dhëna që do të udhëheqin rregullimet dhe përmirësimet e ardhshme në kuadrin rregullator.

Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes: Kjo ministri do të përqendrohet në mbështetje të bizneseve, veçanërisht SME-ve, për t'u përshtatur me kërkesat e reja ligjore. Ajo do të ofrojë trajnim, asistencë financiare dhe shërbime këshillimore për të ndihmuar bizneset të përmbushin ligjin e përditësuar të shoqërive. Ministria gjithashtu do të monitorojë ndikimin social të reformave, veçanërisht për ndërmarrjet më të vogla.

Autoriteti i Konkurrencës: Shoqëritë të sigurojnë përputhshmërinë me rregullat e konkurrencës dhe të njoftojnë Autoritetin e Konkurrencës kur ato përmbushin kriteret e përcaktuara, për të shmangur pasojat

ligjore dhe financiare që mund të lindin nga mosnjohja. Harmonizimi i do të rrisë konkurrencën në tregun lokal, duke mundësuar që bizneset shqiptare të konkurrojnë në kushte të barabarta me ato të vendeve të BE-së. Për më tepër, krijimi i një tregu të hapur dhe të parashikueshëm për investitorët do të ndihmojë në diversifikimin e ekonomisë dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve. Autoriteti i Konkurrencës do të duhet të jetë më i vëmendshëm për përqendrime të reja që mund të krijohen në treg apo mbrojtjen e konkurrencës së pandershme në përgjithësi

Pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur

Për zbatimin e plotë të opsionit të zgjedhur mund të ketë disa pengesa të mundshme. Një pengesë mund të jetë mungesa e kapaciteteve institucionale për të përballuar ngarkesën e shtuar që lidhet me zbatimin e ndryshimeve të reja. Përshtatja e institucioneve shtetërore dhe forcimi i kapaciteteve për të monitoruar dhe zbatuar ndryshimet kërkon investime në trajnim dhe infrastrukturë. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të kenë vështirësi për t'u përshtatur me kërkesat e reja ligjore dhe mund të kërkojnë mbështetje shtesë për të siguruar përputhshmërinë. Për më tepër, mungesa e burimeve për të mbështetur ndryshimet në infrastrukturën digjitale dhe proceset administrative mund të ngadalësojë implementimin. Një pengesë tjetër mund të jetë mungesa e transparencës dhe komunikimit të qartë me bizneset për rregullat dhe procedurat e reja.

Masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës

Për të siguruar qëllimet e politikës dhe për të mundësuar zbatimin e suksesshëm të opsionit të zgjedhur, do të ndërmerren disa masa kyçe. Këto përfshijnë:

- Sigurimi i trajnimeve të vazhdueshme për punonjësit e institucioneve shtetërore, për t'u njohur me kërkesat e reja ligjore dhe për të siguruar implementimin e duhur të ndryshimeve. Pjesëmarrja në trajnime ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me ekspertë do të rrisin aftësitë e këtyre institucioneve.
- Ofrimi i mbështetjes teknike dhe financiare për bizneset për t'i ndihmuar të përmbushin kërkesat e reja ligjore. Kjo mund të përfshijë mundësi për trajnime, udhëzime dhe asistencë për të përmbushur rregullat e reja të regjistrimit dhe të qeverisjes korporative. Po ashtu, mund të krijohen lehtësira për SME për të reduktuar ngarkesat administrative gjatë fazës transpozimit të ndryshimeve.
- Përdorimi i mekanizmave të përhershëm për të monitoruar implementimin dhe për të vlerësuar ndikimet e reformës. Ky mekanizëm do të ndihmojë për të siguruar që ligjet të zbatohen siç duhet dhe që të gjithë aktorët e përfshirë të marrin mbështetje të nevojshme për të përmbushur kërkesat e reja.
- Përdorimi i platformave të komunikimit për të informuar dhe ndihmuar bizneset dhe investitorët për rregullat dhe ndryshimet e reja ligjore. Kjo do të ndihmojë në lehtësimin e kalimit dhe do të sigurojë që të gjitha palët të kenë informacion të qartë dhe të azhurnuar për ndryshimet ligjore dhe procedurat e reja.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

4. *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
5. *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Në përputhje me raportin e progresit të Komisionit Evropian për vitin 2024, Shqipëria inkurajohet të përmirësojë kapacitetet e saj institucionale për monitorimin dhe zbatimin e reformave në ligjin 9901/2008. Raporti thekson se përparimi aktual në harmonizimin e legjislacionit shqiptar me direktivat e BE-së ka qenë i ngadalët, me disa boshllëqe në transpozim dhe zbatim. Qeverisë shqiptare i sugjerohet forcimi i mekanizmave për monitorimin e implementimit të ndryshimeve ligjore dhe sigurinë që ato të zbatohen në mënyrë efektive. Në këtë kontekst, Shqipëria duhet të fokusohet në përmirësimin e koordinimit ndërmjet institucioneve kyçe. Për të adresuar këto boshllëqe, Shqipëria do të duhet të investojë në ndërtimin e

kapaciteteve për këto institucione, duke siguruar që ato të kenë ekspertizën dhe burimet e nevojshme për të zbatuar në mënyrë efektive kuadrin ligjor të përditësuar. Gjithashtu, është thelbësore të krijohen sisteme të qarta monitorimi dhe vlerësimi për të ndjekur përparimin e reformave dhe për të vlerësuar ndikimin e tyre, duke siguruar që Shqipëria të përmbushë detyrimet e saj ndaj BE-së dhe të mundësojë një integrim më të lehtë në tregun e brendshëm të BE-së. Këto hapa do ta ndihmojnë Shqipërinë të arrijë përputhshmërinë e plotë me standardet e BE-së në ligjin 9901/2008 dhe të përmirësojë mjedisin e biznesit, duke nxitur rritjen ekonomike dhe qëndrueshmërinë afatgjatë.

Përshkrimi i masave të monitorimit dhe të vlerësimit:

Për të siguruar që zbatimi i dispozitave të reja të ketë sukses, do të krijohet një mekanizëm i monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm. Ky mekanizëm do të mbikëqyrë implementimin e reformave dhe do të sigurojë që masat e ndërmarra për të arritur objektivat e politikës të realizohen siç është planifikuar. Monitorimi do të përfshijë vlerësimin e progresit nga institucionet shtetërore përgjegjëse, që do të sigurojnë që rregulloret dhe praktikat të zbatohen në përputhje me standardet e BE-së. Pjesë e rëndësishme e këtij procesi do të jetë përfshirja e aktorëve të ndryshëm, përfshirë bizneset dhe shoqërinë civile, për të siguruar një vlerësim të plotë dhe transparent të ndikimeve dhe progresit të masave të reja. Për më tepër, do të realizohet një monitorim i vazhdueshëm i ndikimit të masave në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, për të identifikuar sfida dhe mundësi për përmirësim.

Kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre

Për të matur arritjen e objektivave të politikës dhe progresin në implementimin e dispozitave të harmonizuara me acquis-in e BE-së, do të përdoren disa kriteret dhe tregues të qartë. Këto përfshijnë:

- **Përputhshmëria:** Një nga kriteret kryesore do të jetë vlerësimi i nivelit të përputhshmërisë, duke siguruar që të gjitha amendimet dhe shtesat e nevojshme janë miratuar dhe implementuar plotësisht.
- **Rritja e FDI:** Një tregues tjetër i rëndësishëm është vlerësimi i rritjes së investimeve të huaja të drejtpërdrejta pas implementimit të ndryshimeve ligjore, si dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e sektorëve të ndryshëm ekonomikë. Ky tregues do të matet nëpërmjet raporteve të institucioneve financiare dhe statistikave zyrtare.
- **Përmirësimi i klimës së biznesit:** Ky tregues do të matet nëpërmjet vlerësimeve dhe raportimeve mbi përmirësimin e klimës së biznesit, si dhe nga ecuria e procedurave për regjistrimin e bizneseve dhe lehtësimin e procedurave administrative.
- **Ndikimi tek bizneset në përgjithësi dhe NMV-të në veçanti:** Tregues të tjerë do të përfshijnë vlerësimin e ndikimit në shoqëritë tregtare, duke marrë parasysh se sa mirë këto biznese kanë mundur të përshtaten me ligjet e reja dhe sa lehtë kanë mundur të hyjnë në tregje të reja.
- **Përmirësimi i kapaciteteve institucionale:** Do të maten përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve në institucione si QKB dhe MEKI, përmes trajnimeve dhe përmirësimit të infrastrukturës për zbatimin e rregulloreve të reja. Kjo do të ndikojë drejtpërdrejt në mundësinë e mbikëqyrjes efektive të ligjeve të reja.

Këto tregues do të përdoren për të monitoruar dhe vlerësuar progresin dhe për të identifikuar nevojën për përmirësime në masat e ndërmarra, duke siguruar që objektivat e politikës të realizohen në kohë dhe me efektivitet.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Në analizën e mëposhtme janë marrë në konsideratë vetëm përfitimet për arsye se kostot janë jo vetëm të papërcaktueshme me besueshmëri, por edhe sepse vlera e tyre është jo e rëndësishme krahasimisht me përfitimet.

Shifrat në tabelë janë të shprehura në milionë (000 000) Lekë.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	1.00	0.95	0.91	0.87	0.82	0.79	0.75	0.71	0.68	0.65
Kosto për buxhetin - një herë										
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi										
Kosto për bizneset - një herë										
Kosto për bizneset - në vazhdimësi										
Kosto për grupet e tjera - një herë										
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi										
Kosto në total										
Kosto e zbritur = Kosto në total x Faktori zbritës										
Përfitimet për buxhetin – një herë										
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi	472	472	472	472	472	472	472	472	472	472

Përfitimet për grupet e tjera – një herë										
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi										
Përfitimet për biznesin – një herë										
Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi										
Përfitimet totale	472	472	472	472	472	472	472	472	472	472
Përfitimi i zbritur = Përfitimi në total x faktori zbritës	472	448.4	429.52	410.64	387.04	372.88	354	335.12	320.96	306.8
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total	3,837									
Vlera prezente aktuale e kostos në total										
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	3,837									

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsiioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	-	3,837	3,837
Opsioni 2	0	0	0
Opsioni 3			

MINISTËR

BLENDI GONXHJA